

Krimet e Zgjedhjeve

Analizë e ndjekjes penale dhe gjykimit të rasteve të krimeve të zgjedhjeve në Kosovë



Ky studim është rezultat i punës kërkimore në programin e KIPRED-it për sundim të ligjit, që përkrahet nga Fondi i Vëllezërve Rockefeller (RBF) dhe programin e zgjedhjeve që përkrahet nga Qeveria e Britanisë së Madhe përmes Ambasadës Britanike në Prishtinë. Gjetjet dhe rekomandimet e këtij studimi janë përgjegjësi e KIPRED-it.

Përgatitur nga: Adem Gashi dhe Betim Musliu
Redaktuar nga: Krenar Gashi

Ky botim është pronë intelektuale e institutit KIPRED. Të gjitha të drejtat, përfshirë ato autoriale, janë të rezervuara dhe të mbrojtura me ligj. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk guxon të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë, pa pëlqimin paraprak me shkrim nga botuesi. Botimi mund të shpërndahet në formë elektronike por vetëm si tërësi dhe vetëm për qëllime jokomerciale.

Botuar nga



Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillim të Politikave
Rr. Rexhep Mala, nr. 5A
10 000 Prishtinë, Kosovë
Telefoni dhe faksi: +381 38 227 778
kipred.net

PËRMBAJTJA:

1. Hyrje	5
2. Historik i shkurtër i krimeve të zgjedhjeve	7
3. Zgjedhjet parlamentare 2010	9
3.1. Ankesat e organizatave dhe subjekteve politike në KQZ për zgjedhjet 2010.....	12
3.2. Rinumërimi i votave.....	13
4. Korniza ligjore për ndjekjen dhe gjykimin e krimeve të zgjedhjeve.....	15
5. Dëmet e manipulimeve të zgjedhjeve.....	17
6. Roli dhe efikasiteti i Prokurorive Komunale.....	20
6.1. Ngritja e aktakuzave të drejtpërdrejta	21
7. Angazhimi i gjykatave në zgjidhjen e lëndëve	23
7.1. Efikasiteti i gjykatave në zgjidhjen e lëndëve	24
7.2. Dënimet e shqiptuara nga Gjykatat Komunale	27
8. Ndjekja penale si Krim i Organizuar	31
8.1. Dështimi i materialeve zgjedhore.....	32
8.2. Manipulimi i numërimit të votave.....	33
8.3. Baza ligjore për ndjekjen e krimeve të zgjedhjeve si krim i organizuar	34
9. Gjetjet e përgjithshme.....	36
10. Rekomandimet	39

SHKURTESAT:

AAK	Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës
AKR	Aleanca Kosova e Re
BIRN	Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese
CEEOMV	Këshilli i Evropës Misioni për Vëzhgimin e Zgjedhjeve në Kosovë
ENEMO	Rrjeti Evropian i Organizatave për Monitorimin e Zgjedhjeve
FER	Fryma e Re
FRK	Formularët e Rezultateve të Kandidatëve
KDI	Instituti Demokratik i Kosovës
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KIPRED	Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave
KKZ	Komisioni Komunal Zgjedhor
KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
KVV	Këshill të Vendvotimit
KZAP	Komisioni për Zgjidhjen e Ankesave dhe Parashtresave
LDK	Lidhja Demokratike e Kosovës
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PDK	Partia Demokratike e Kosovës
PSRK	Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës
PZAP	Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
QNR	Qendra për Numërim dhe Rezultate

1. HYRJE

Zgjedhjet janë themeli i një shoqërie demokratike. Ndërtimi i institucioneve përfaqësuese, të cilat bartin përgjegjësinë për të drejtuar shtetin, e me të edhe shoqërinë, duhet të bazohet në vullnetin e shumicës së qytetarëve. Organizimi i zgjedhjeve të lira e demokratike dhe cilësia e organizimit dhe mbarëvajtjes së zgjedhjeve është një ndër pikat kyçe të vlerësimit të demokracive të reja dhe atyre në tranzicion.¹ Si vend që është në përpjekje e sipër për të ndërtuar një demokraci pluraliste dhe funksionale, Kosova duhet medoemos që të jetë në gjendje të organizojë zgjedhje në pajtim me standardet ndërkombëtare të cilat i kanë përqaftuar vendet e tjera demokratike.

Në Republikën e Kosovës, qytetarët zgjedhin përfaqësuesit e vet të Kuvendit të Kosovës, organit më të lartë institucional, e po ashtu bëjnë përzgjedhjen e këshilltarëve të kuvendeve komunale dhe të kryetarëve të komunave në mënyrë të drejtpërdrejtë. Së shpejti, kosovarët do të zgjedhin përmes votës së lirë dhe të drejtpërdrejtë edhe shefin e shtetit, gjegjësisht Presidentin e Republikës.² Trupi më i lartë që mban përgjegjësinë për organizimin dhe mbarëvajtjen e zgjedhjeve është Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ).

Pas luftës, nën administrimin ndërkombëtar, Kosova pati organizuar zgjedhjet e para lokale në vitin 2000, ndërsa ato për Kuvend të Kosovës në vitin 2001. Zgjedhjet komunale janë mbajtur edhe në vitin 2002, e pastaj u pasuan me zgjedhjet në vitin 2004, të cilat u mbajtën në të njëjtën kohë me zgjedhjet nacionale. Në vitin 2007, autoritetet kosovare kishin marrë më shumë kompetenca në procesin e zgjedhjeve dhe janë organizuar tri palë zgjedhje përnjëherë, ku qytetarët për herë të parë patën zgjedhur përfaqësuesit e tyre në Kuvend të Kosovës, kuvende komunale dhe kryetarët e tyre të komunave përmes votimit të drejtpërdrejtë me lista të hapura.

Të gjitha këto zgjedhje u patën vlerësuar si zgjedhje të organizuara mirë, sipas standardeve ndërkombëtare dhe si shembull për vendet e rajonit. Por zgjedhjet komunale të vitit 2009, të parat të organizuara krejtësisht nga autoritetet vendore dhe pas shpalljes së pavarësisë, e sidomos zgjedhjet nacionale të vitit 2010, kanë shënuar një rënie drastike sa i përket organizimit dhe rrjedhës së tyre. Manipulimet me votën e lirë të qytetarëve patën arritur kulmin në dhjetor të vitit 2010 të cilat e patën dëmtuar rëndë gjithë procesin zgjedhor. Fenomenet e mbushjeve masive të kutive me fletëvotime dhe metodave tjera më të sofistikuar të manipulimeve i dhanë një hije të zezë gjithë demokracisë dhe shtetësisë së Kosovës.

Parregullsitë dhe manipulimet e shumta ishin në fokus të kritikave të miqve ndërkombëtarë. Ambasadat e shteteve që fuqimisht përkrahin Kosovën, vëzhguesit vendorë e sidomos ata ndërkombëtarë, por edhe vet partitë politike nuk kursyen fjalë për të përshkruar atë që ndodhi me 12 dhjetor 2010.

¹ Raportet e organizatave si Freedom House, OSBE Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejta të Njeriut, Komisioni Evropian, dhe organizatave e institucioneve tjera përdorin ndër të tjera edhe këto indekse.

² Më 7 prill 2011, Kuvendi i Kosovës ka aprovuar një rezolutë e cila thekson se Kuvendi i Kosovës do të krijojë një Komision Parlamentar i cili do të merret me ndryshimin e Kushtetutës ashtu që në të ardhmen Presidenti i Republikës së Kosovës do të zgjedhet drejtpërdrejt nga populli. Procesverbal i Mbledhjes Plenare të Kuvendit të Kosovës. Kuvendi i Kosovës. 7 prill 2011.

Si pasojë e keqpërdorimeve të shumta, Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) kishte pranuar gjithsej 454 ankesa të cilat ndërlidheshin me parregullsi dhe manipulimin e zgjedhjeve të mbajtura në dhjetor 2010 dhe rivotimit në janar 2011.³ Disa nga këto ankesa kanë bërë që KQZ pas vendimeve të PZAP-it të vendosë për rizgjedhje në Skenderaj, Drenas dhe Deçan, dhe në dy vendvotime, një në Lipjan dhe tjetri në Malishevë.⁴ Ndërsa pas ankesës së Lëvizjes Vetëvendosje në Gjykatën Supreme rreth vendvotimeve në Mitrovicë, kjo komunë shkoi në rivotim.⁵

Zyrtarë nga partitë politike në pushtet, me të përfunduar procesi i rivotimit, nxituan të fajësonin sistemin zgjedhor për manipulimet, duke kontribuar kështu në një amnisti pararendëse për manipuluesit e zgjedhjeve. Si pasojë, Kuvendi i Kosovës emëroi një komision të veçantë parlamentar i cili po merret me amendamentimin e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë.⁶

Megjithatë, ajo që mbeti shqetësuese ishte fakti që manipuluesit e vullnetit të popullit nuk u përballën me një dorë të fortë të drejtësisë, ashtu siç do duhej të ndodhte. Madje edhe dënimet e pakta dhe të ulëta që u shqiptuan mund të cilësohen sikur tarifa për blerje të votave, rrjedhimisht legalizim i tregtisë me votat.

Në këtë studim, Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave (KIPRED) do të analizojë ndjekjen penale të atyre që manipuluan procesin zgjedhor, duke u përqendruar më shumë në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2010.

³ Komunikim i KIPRED-it përmes postës elektronike me Sekretarin e Përhershëm të PZAP-it, z. Mulë Desku, tetor 2011.

⁴ Vendimi për përsëritjen e votimit të Zgjedhjeve në Kuvendin e Republikës së Kosovës në Komunitat Drenas, Skenderaj dhe Deçan si dhe përsëritjen e votimit në disa QV në Komunitat Lipjan dhe Malishevë, vendimi numër 1621-2010. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Dhjetor 2010.

⁵ Rivotimi në komunën e Mitrovicës është bërë pasi që Gjykata Supreme kishte qenë në favor të ankesave në këtë komunë, më saktësisht Vendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës A.A.nr. 37/2011 të datës 6 janar 2011 për miratimin e ankesës dhe anulimin e vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa numër 442/2010 të datës 31 dhjetor 2010. Një vendim i tillë i Gjykatës Supreme ishte shndërruar në vendim të KQZ-së për rivotim në komunën e Mitrovicës. Vendimi për përsëritjen e votimit për Kuvendin e Republikës së Kosovës të 12 dhjetorit 2010 në Komunën e Mitrovicës.

⁶ Në ditën e zgjedhjes së Presidentit të Republikës së Kosovës më 7 prill 2011, Kuvendi i Kosovës me 75 vota për kishte aprovuar një rezolutë e cila përmbante marrëveshjen e lidhur në mes të Z. Isa Mustafa, Kryetar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, z. Hashim Thaçi, Kryetar i Partisë Demokratike të Kosovës, dhe z. Behgjet Pacolli, Kryetar i Koalicionit për Kosovën e Re. Rezoluta e mbështetur nga Kuvendi i Kosovës është përshkruar në Procesverbalin e Mbledhjes Plenare të Kuvendit të Kosovës, të mbajtur me 7 prill 2011. Kuvendi i Kosovës. 7 prill 2011.

2. HISTORIK I SHKURTËR I KRIMEVE TË ZGJEDHJEVE

Në të kaluarën, rastet e manipulimit dhe vjedhjes së votës gjatë zgjedhjeve në Kosovë nuk janë trajtuar me prioritet dhe përgjegjësi të plotë nga ana e policisë, prokurorëve dhe gjykatësve në ndjekjen dhe gjykimin e këtyre rasteve.⁷ Vjedhjet masive në zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës në vitin 2010 dhe dëmi i madh që ishte shkaktuar kanë detyruar Gjykatën Supreme dhe Prokurorin e Shtetit që lëndët e zgjedhjeve, përfshirë ato të viteve të mëparshme, të zgjidhen me prioritet.⁸ Baza për ndjekjen e keqpërdorimeve në zgjedhje është siguruar përmes ankesave të cilat janë paraqitur në PZAP.⁹ Ky organ gjyqësor i formuar enkas për procesin zgjedhor merret me shqyrtimin e ankesave dhe parashtesave të të gjitha palëve që kanë të bëjnë me parregullsi gjatë procesit zgjedhor.¹⁰ Të gjitha vendimet e PZAP-it, të cilat vërtetojnë çfarëdo shkelje apo manipulimi me procesin zgjedhor, janë dërguar tek Prokurori i Shtetit për të vazhduar me hetime të mëtejme penale.¹¹ Pas dorëzimit në organin më të lartë të ndjekjes, nga Prokurori i Shtetit lëndët për zgjedhjet janë shpërndarë nëpër prokuroritë komunale kompetente për të zhvilluar hetime sipas detyrës zyrtare.¹² Gabim i kushtueshëm ka qenë mostrajtimi me prioritet i lëndëve të zgjedhjeve në të kaluarën, gjë që ka rezultuar me përsëritjen dhe shtimin e manipulimit të zgjedhjeve në mënyrë graduale.

Në praktikë në të kaluarën për rastet e zgjedhjeve rezulton se kanë dështuar tri hallkat e sistemit të drejtësisë, përfshirë policinë, prokuroritë dhe gjykatat. Megjithëse zgjedhjet e përgjithshme dhe lokale të organizuara në vitin 2007 ishin konsideruar si të pranueshme dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe ligjet e Kosovës,¹³ një numër i shkeljeve ishin raportuar gjatë ditës së zgjedhjeve. Këto shkelje sigurisht që kanë pasur ndikim negativ, megjithatë raportimi i tyre është një gjë pozitive. KZAP për zgjedhjet e vitit 2007 kishte dërguar tek Prokurori i Shtetit (ish Prokuroria Publike e Kosovës) mbi 100 dosje.¹⁴ Mirëpo, çështja më shqetësuese për rastet e këtyre zgjedhjeve mbetet ndjekja e rasteve të manipulimit nga organet e drejtësisë. Në maj 2009, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) kishte nxjerrë një raport i cili vlerësonte se edhe një vit e gjysmë pas përfundimit të procesit zgjedhor të vitit 2007, organet e drejtësisë kanë qenë mjaft të padobishme në zgjidhjen e rasteve të zgjedhjeve.¹⁵ Mosndëshkimi i manipulimit të zgjedhjeve në të kaluarën

⁷ Raporti mujor – Maj 2009. Departamenti për të Drejta të Njeriut dhe Komunitete. Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë Misioni në Kosovë. Maj 2009.

⁸ Intervistat e KIPRED-it me Kryetarin e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, z. Fejzullah Hasani, gusht 2011, dhe Kryeprokurorin e Shtetit, z. Ismet Kabashi, korrik 2011.

⁹ PZAP në zgjedhjet e kaluara është njohur si Komisioni për Zgjidhjen e Ankesave dhe Parashtesave (KZAP)

¹⁰ Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Ligji numër 03/L-073. Po ashtu, Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit numër 03/L-073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, Ligji numër 03/L-256.

¹¹ Komunikim i KIPRED-it përmes postës elektronike me Sekretarin e Përhershëm të PZAP-it, z. Mulë Desku, gusht 2011.

¹² Intervistë e KIPRED-it me Prokuroren e Prokurorit të Shtetit dhe Koordinatorin për lëndët e zgjedhjeve, znj. Laura Pula, korrik 2011.

¹³ Këshilli i Evropës Misioni për Vëzhgimin e Zgjedhjeve në Kosovë (CEEOMV) ka nxjerrë përfundimin se zgjedhjet e vitit 2007 kanë qenë në përgjithësi në linjë me principet e Këshillit të Evropës. Deklaratë preliminare. Këshilli i Evropës. Nëntor 2007.

¹⁴ “Shqyrtimi i rasteve të mashtrimit në zgjedhje nga prokurorët publikë komunalë të Kosovës”; Raporti mujor i OSBE-së; Departamenti për të Drejta të Njeriut dhe Komunitete; Sektori për Monitorimin e Sistemit Ligjor; maj 2009

¹⁵ Në bazë të OSBE-së, një vit e gjysmë pas përfundimit të procesit zgjedhor nuk është zhvilluar asnjë proces gjyqësor për ndonjërin nga rastet e mashtrimeve në zgjedhje. Raporti mujor – Maj 2009. Departamenti për të Drejta të Njeriut dhe Komunitete. Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë Misioni në Kosovë. Maj 2009.

patjetër se ka ndikuar që të njëjtat të jenë prezent edhe në zgjedhjet e organizuara me 2009 dhe 2010, madje në shkallë shumë më të madhe.

Prej mbi 100 dosjeve të pranuar nga Prokurori i Shtetit për zgjedhjet e vitit 2007, prokurorët komunal kanë arritur të shqyrtojnë vetëm 36 raste, në të cilat janë përfshirë 57 persona të pandehur.¹⁶ Deri në maj të vitit 2009, nga të gjitha rastet e zgjedhjeve të vitit 2007, tetë raste ishin hedhur poshtë, 16 raste kanë ngecur ose kanë qenë në pritje për t'u zgjidhur, janë ngritur 12 aktakuza, ndërsa për asnjë prej këtyre rasteve nuk është mbajtur ndonjë proces gjyqësor.¹⁷ Shih përmbledhjen e rasteve të zgjedhjeve 2007 në tabelën 1.

Proceset	Numri i Rasteve	Progresi
Numri i dosjeve që KZAP dorëzoi në Prokurori të Shtetit	100	-
Progresi në shqyrtimin e rasteve nga Prokuroritë Publike Komunale	36	36%
Procese Gjyqësore	0	0%

Tabela 1 - Ndjekja dhe gjykimi i lëndëve të zgjedhjeve 2007 deri në maj 2009

Rastet e zgjedhjeve 2009 gjithashtu janë zvarritur dhe nuk janë trajtuar seriozisht nga sistemi i drejtësisë. Zyrtarët më përgjegjës për ndjekjen e këtyre manipulimeve natyrisht se janë prokurorët, të cilët nuk i janë përgjigjur plotësisht detyrës së tyre zyrtare.

Në vitin 2009, Rrjeti Evropian i Organizatave për Monitorimin e Zgjedhjeve (ENEMO) ngriti shqetësimin se gjykatat nuk kishin arritur të zgjidhin asnjë nga rastet e manipulimit të zgjedhjeve të vitit 2007, të cilat KZAP i kishte dorëzuar tek prokuroritë.¹⁸ Për zgjedhjet e vitit 2009, KZAP kishte pranuar 55 ankesa para ditës së zgjedhjeve dhe 112 ankesa gjatë ditës së zgjedhjeve.¹⁹ Një numër i madh i ankesave ndërlihdeshin me shkatërrimin apo vendosjen gabim të posterëve të kandidatëve që përbënte shkelje të Kodit të Mirësjelljes. Sa i përket raundit të dytë të zgjedhjeve për kryetar të Komunave, KZAP kishte pranuar 61 ankesa, të cilat ndërlihdeshin me keqpërdorime gjatë votimit.²⁰ Ankesat përmbanin prova të mjaftueshme kështu që KQZ kishte vendosur që të përsëriten zgjedhjet në tri komuna duke përfshirë Prizrenin, Gjilanin, dhe Lipjanin.²¹ Pra, tri hallkat e sistemit të drejtësisë kanë dështuar në trajtimin e rasteve të manipulimit të zgjedhjeve në vitet 2007 dhe 2009, duke krijuar një sistem, i cili nuk ndëshkon shkelësit dhe manipuluesit e zgjedhjeve.

¹⁶ Raporti mujor – Maj 2009. Departamenti për të Drejta të Njeriut dhe Komunitete. Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë Misioni në Kosovë. Maj 2009.

¹⁷ “Shqyrtimi i rasteve të mashtrimit në zgjedhje nga prokurorët publikë komunalë të Kosovës”; Raporti mujor i OSBE-së; Departamenti për të Drejta të Njeriut dhe Komunitete; Sektori për Monitorimin e Sistemit Ligjor; maj 2009

¹⁸ Zgjedhjet lokale 2009, raporti përfundimtar. Rrjeti Evropian i Organizatave për Monitorimin e Zgjedhjeve (ENEMO).

¹⁹ Po aty.

²⁰ Po aty.

²¹ Po aty.

3. ZGJEDHJET PARLAMENTARE 2010

Përfaqësuesit e popullit të dalë nga zgjedhjet e vitit 2007 kishin shpallur pavarësinë e Republikës së Kosovës në shkurt të vitit 2008.²² Këto zgjedhje krijuan koalicionin qeverisës ndërmjet dy forcave më të mëdha politike Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), duke lënë në opozitë partitë me fuqi dukshëm më të vogël. Megjithatë, koalicioni qeverisës ishte mjaft i brishtë. Ende pa i mbushur tri vjet të mandatit qeverisës, koalicioni u thye. Rrëzimi i Qeverisë erdhi në nëntor të vitit 2010 pas ngritjes së mocionit për mosbesim ndaj Qeverisë në Kuvendin e Kosovës, të cilin e kishin votuar vetë anëtarët e koalicionit.²³ Rrjedhimisht, vendi shkoi drejt zgjedhjeve të jashtëzakonshme parlamentare që u caktuan për 12 dhjetor 2010.²⁴ Në këtë datë, Kosova organizoi zgjedhjet e para parlamentare si shtet i pavarur ku autoritetet vendore kanë qenë përgjegjëse për organizimin dhe mbarëvajtjen e të gjithë procesit. Duke pasur parasysh se koha për organizimin e këtyre zgjedhjeve ishte shumë e shkurtër, kishte skepticizëm rreth kapaciteteve të KQZ-së për organizimin dhe mbarëvajtjen e zgjedhjeve në rrethana të jashtëzakonshme. KQZ-ja, e cila përbëhet nga 11 anëtarë, është organi përgjegjës për organizimin e zgjedhjeve në Kosovë dhe mbarëvajtjen e tyre.²⁵ Kryesuesi i KQZ-së është gjykatës i Gjykatës Supreme apo Gjykatave me juridiksion apeli dhe emërohet nga Presidenti i Republikës së Kosovës. Ndërsa 10 anëtarët e tjerë emërohen nga grupet parlamentare në Kuvendin e Kosovës.²⁶ KQZ, Policia e Kosovës, partitë politike, vëzhgues vendorë e ndërkombëtar dhe institucione e organizatat tjera kishin ndërmarrë një sërë masash për të siguruar mbarëvajtjen e procesit të zgjedhjeve.

Për të evituar sa më shumë keqpërdorimin, në secilin Këshill të Vendvotimit (KVV) ishin caktuar shtatë (7) komisionerë të cilët kishin përgjegjësi të ndryshme.²⁷ Detyrat e secilit prej tyre ishin ndarë në mënyrë të qartë ku një kontrollonte gishtin me bateri ultravjollcë, një tjetër kontrollonte dokumentet e identifikimit dhe gjente hapësirën ku duhej vendosur nënshkrimi i personit, një tjetër kujdesej që të vendos vulë në fletëvotim dhe të dorëzoj atë tek votuesi, një tjetër spërkat gishtin me ngjyrë të padukshme, dhe një tjetër do të sigurohej se fletëvotimi është futur në kutinë e duhur. Me përfundim të procesit të votimit, KVV ka vazhduar me procesin e numërimit të votave. Përgjegjës sërish ishin komisionerët e KVV-ve të cilët numëronin dhe plotësonin të gjitha informatat në formularët që do të dorëzoheshin në KQZ, ku në mesin e këtyre informatave do të futeshin të dhënat për numrin e votave për parti dhe për secilin kandidat. Pas përfundimit të procesit të numërimit, të shtatë komisionerët do të nënshkruanin në formularë për të vërtetuar mbarëvajtjen dhe saktësinë e procesit. Për të

²² Me 17 shkurt 2008, Kuvendi i Kosovës në orën 15:00 ka mbajtur seancë të jashtëzakonshme në të cilën është shpallur pavarësia e Republikës së Kosovës. Mbledhja e jashtëzakonshme e Kuvendit të Kosovës. Kuvendi i Kosovës. Shih <http://www.assembly-kosova.org/?cid=1,128,1637> (qasur për herë të fundit më 4 tetor 2011).

²³ Gashi K. "Shkaqet dhe shkasit e krizës institucionale në Kosovë." Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave. Nëntor 2010.

²⁴ Shpërbëhet Kuvendi i Kosovës. Kuvendi i Republikës së Kosovës. Shih <http://www.assembly-kosova.org/?cid=1,128,3502> (qasur për herë të fundit më 4 tetor 2011).

²⁵ Neni 139, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Kushtetuta e Republikës së Kosovës.

²⁶ Neni 139, alinea 3 dhe 4, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Kushtetuta e Republikës së Kosovës.

²⁷ Votimi dhe Numërimi brenda Vendvotimeve në nivelin e Komisionit Komunal Zgjedhor. Rregullën Zgjedhore Nr. 09/2009. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

ofruar siguri për të gjithë komisionerët dhe personat e përfshirë në organizimin e zgjedhjeve, Policia e Kosovës kishte vendosur zyrtarët policor pranë të gjitha qendrave të votimit.

Monitorimi i zgjedhjeve është bërë nga një numër i madh dhe i ndryshëm i akterëve duke përfshirë vëzhguesit e partive politike, shoqërisë civile, medieve, organizatave ndërkombëtare, dhe zyrtarëve ndërkombëtar. Shoqëria civile u përfshi në monitorimin e zgjedhjeve përmes një koalicioni të gjerë “Demokracia në Veprim”, që tashmë kishte krijuar përvojë pasi që nga viti 2007 kishte vëzhguar të gjitha zgjedhjet e organizuara në Kosovë. Për zgjedhjet e vitit 2010, ky koalicion i udhëhequr nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) kishte angazhuar afër 5,000 vëzhgues.²⁸ Presidenti në detyrë, z. Jakup Krasniqi, kishte ftuar organizatën ENEMO për të vëzhguar procesin para dhe ditën e zgjedhjeve, ku kjo organizatë në Misionin e Vëzhgimit të Zgjedhjeve kishte angazhuar 188 vëzhgues në ditën e zgjedhjeve.²⁹ Në monitorim të zgjedhjeve u përfshinë edhe një numër i zyrtarëve ndërkombëtar duke përfshirë parlamentar të BE-së, zyrtarë të ambasadave të huaja dhe organizatave ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë.

Përkundër angazhimit të një spektri të gjerë të shoqërisë dhe institucioneve në ditën e zgjedhjeve u shënuan një numër i madh i parregullsive të cilat dëmtojnë dhe cenuan organizimin e zgjedhjeve të lira. Për zgjedhjet parlamentare të 12 dhjetorit 2010, PZAP ka pranuar 363 ankesa të cilat ndërlidheshin me parregullsitë e zgjedhjeve.³⁰ Duke u bazuar në këto ankesa, PZAP ka vendosur për rizgjedhje në Skenderaj, Drenas dhe Deçan, dhe në dy vendvotime, një në Lipjan dhe tjetri në Malishevë.³¹ Ndërsa pas ankesës së Lëvizjes Vetëvendosje në Gjykatën Supreme rreth vendvotimeve në Mitrovicë, kjo komunë shkoi në rivotim.³² PZAP-ja pranoi edhe 91 ankesa tjera që ndërlidheshin me procesin e rivotimit, duke qarë përfundimisht numrin e përgjithshëm të ankesave në 454 sosh.³³ Në vendvotimet në të cilat u përsëritën zgjedhjet, dalja në rivotimin e organizuar në janar 2011 ishte dukshëm më e vogël se ajo që u shënuar në procesin e votimit të mbajtur në dhjetor 2010.³⁴ Rënia drastike në numrin e votuesve vetëm sa e fuqizon argumentin se shkeljet nëpër këto

²⁸ Sipas Koalicionit të OIQ-ve Demokracia në Veprim, 5,000 vëzhgues do të angazhoheshin në monitorimin e procesit të votimit që do të zhvillohej nga ora 7:00 deri 19:00 dhe procesin e numërimit të votave që do të fillonte nga ora 19:00. Komunikatë për Media. Demokracia në Veprim. 1 dhjetor 2010. Shih http://www.demokracianeveprim.org/al/index.php?subaction=showfull&id=1291217168&archive=&start_from=&ucat=& (qasur për herë të fundit më 1 tetor 2011)

²⁹ Zgjedhjet Parlamentare në Kosovë 2010 – Raporti Final. Misioni për Vëzhgimin e Zgjedhjeve. Rrjeti Evropian i Organizatave për Monitorimin e Zgjedhjeve (ENEMO). Prill 2011.

³⁰ Ejupi B., dhe Qavdarbasha Sh. “Zgjedhjet Parlamentare në Kosovë 2010: Vështirësi të përgjithshme dhe trendet”. KIPRED. Prill 2011.

³¹ Vendimi për përsëritjen e votimit të Zgjedhjeve në Kuvendin e Republikës së Kosovës në Komunitat Drenas, Skenderaj dhe Deçan si dhe përsëritjen e votimit në disa QV në Komunitat Lipjan dhe Malishevë, vendimi numër 1621-2010. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Dhjetor 2010.

³² Rivotimi në komunën e Mitrovicës është bërë pasi që Gjykata Supreme kishte qenë në favor të ankesave në këtë komunë, më saktësisht Vendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës A.A.nr. 37/2011 të datës 6 janar 2011 për miratimin e ankesës dhe anulimin e vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës numër 442/2010 të datës 31 dhjetor 2010. Një vendim i tillë i Gjykatës Supreme ishte shndërruar në vendim të KQZ-së për rivotim në komunën e Mitrovicës. Vendimi për përsëritjen e votimit për Kuvendin e Republikës së Kosovës të 12 dhjetorit 2010 në Komunën e Mitrovicës.

³³ Komunikim i KIPRED-it përmes postës elektronike me Sekretarin e Përhershëm të PZAP-it, z. Mulë Desku, tetor 2011.

³⁴ Rezultatet preliminare tregojnë se dalja në zgjedhje të organizuara në dhjetor 2010 kishte qenë 43.4% në Deçan, 86.9% në Glllogoc, 93.7% në Skenderaj, dhe 37% në Mitrovicë. Ndërsa pas përfundimit të procesit të rivotimit dalja në këto qendra kishte qenë dukshëm më e vogël ku në Deçan kishte zbritur në 34.6% (apo 8.8% më pak se sa gjatë votimit në dhjetor 2010), Glllogoc 55.9% (-31%), Skenderaj 59.8% (-33.9%), dhe Mitrovicë 27% (-10%). Zgjedhjet Parlamentare në Kosovë 2010 – Raporti Final. Misioni për Vëzhgimin e Zgjedhjeve. Rrjeti Evropian i Organizatave për Monitorimin e Zgjedhjeve (ENEMO). Prill 2011.

vendvotime ishin të një shkalle të lartë dhe tregon për dëmin e madh që shkakton manipulimi i zgjedhjeve ku numri i votave të keqpërdorura apo të shtuara arrin në dhjetëra mijëra sosh.

Ndryshe nga zgjedhjet e kaluara, rastet e manipulimit të zgjedhjeve të përgjithshme të mbajtura në vitin 2010 dhe ato të procesit të ri-votimit gjatë muajit janar 2011, ishin shpallur lëndë me prioritet nga ana e Prokurorit të Shtetit dhe Gjykatës Supreme.³⁵ PZAP i ka përcjellë tek Prokurori i Shtetit të gjitha ankesat që janë paraqitur në këtë institucion që ndërlidhen me procesin zgjedhor dhe njëkohësisht Qendra për Numërim dhe Rezultate (QNR) ka dorëzuar të dhënat për parregullsitë që janë gjetur gjatë auditimit të formularëve për kandidatët.³⁶ Të gjitha këto në një formë paraqesin materiale të njaftueshme që Prokuroritë Publike Komunale të ngritin akuza ndaj atyre që kanë bërë mashtrime në zgjedhje. Për më tepër, në një numër të madh të rasteve është dashur bashkëpunim i ngushtë i më shumë se dy personave për manipulim të zgjedhjeve, që jep sinjal se në këto raste akuzat duhet të ngritën ndaj grupeve të cilat kanë bashkëpunuar për të bërë shkeljet në zgjedhje.

Vjedhja e votave apo manipulimi me to është bërë me dijeni dhe përfshirje të shtatë anëtarëve të KVV-ve, të cilët kanë lejuar apo kanë marrë pjesë aktive në manipulim. Këta anëtarë kanë qenë të pranishëm kur kanë arritur materialet e zgjedhjeve, gjatë procesit të votimit, dhe gjatë procesit të numërimit të votave. Në përfundim të procesit të numërimit të gjithë këta anëtarë janë nënshkruar në formularët të cilët kanë përmbajtur numrin e votave për secilin subjekt politik dhe secilin kandidat. Asnjë formular nuk është marrë si i plotë në qoftë se ka munguar nënshkrimi i ndonjërit prej anëtarëve. Andaj, manipulimi me rezultate ka qenë mirë i koordinuar dhe ka kërkuar që në këtë proces të jenë të përfshirë më shumë se një apo dy persona, duke arritur kështu që për rastet e manipulimit me formularët, në çdo vendvotim të jenë të paktën shtatë persona bashkëpjesëmarrës të krimit.

Elita politike ka parë reformimin e sistemit zgjedhor si rrugëdalje nga gjendja në të cilën është zhytur vendi pas procesit të dëmtuar zgjedhor. Reforma zgjedhore njëkohësisht është parë si mjet për të siguruar se në të ardhmen numri i parregullsive do të zvogëlohet apo eliminohet. Në këtë frymë ka filluar ndryshimi i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ligji për zgjedhjet e përgjithshme dhe legjislacioni i ndërlidhur, duke aluduar se krijimi i më shumë zonave zgjedhore³⁷ do të zgjidh edhe problemet e manipulimit të zgjedhjeve. Subjektet politike janë bartësit kryesor të parregullsive që janë shkaktuar në procesin zgjedhor, dhe si të tilla është dashur të tregojnë vullnet dhe angazhim më të lartë në denoncimin e kësaj dukurie. Angazhimi i tyre minimal për të dëshmuar parregullsitë pranë organeve të gjyqësorit tregon se ato kanë gabuar kahjen e energjive të tyre për të siguruar zgjedhje të lira në të ardhmen.

³⁵ Intervistë e KIPRED-it me Prokurorin në Prokurorin e Shtetit dhe njëkohësisht Koordinatorin për lëndët e zgjedhjeve, Znj. Laura Pula, qershor 2011. Intervistë e KIPRED-it me Kryetarin e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Z. Fejzullah Hasani, korrik 2011.

³⁶ Komunikim i KIPRED-it përmes postës elektronike me Zyrtarë të Lartë të Sekretariatit të KQZ-së, korrik 2011.

³⁷ Në ditën e zgjedhjes së Presidentit të Republikës së Kosovës më 7 prill 2011, Kuvendi i Kosovës me 75 vota për kishte aprovuar një rezolutë e cila përmbante marrëveshjen e lidhur në mes të Z. Isa Mustafa, Kryetar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, z. Hashim Thaçi, Kryetar i Partisë Demokratike të Kosovës, dhe z. Behgjet Pacolli, Kryetar i Koalicionit për Kosovën e Re. Rezoluta e mbështetur nga Kuvendi i Kosovës është përshkruar në Procesverbalin e Mbledhjes Plenare të Kuvendit të Kosovës, të mbajtur me 7 prill 2011. Kuvendi i Kosovës. 7 prill 2011.

Bazuar në numrin e vëzhguesve dhe diversitetin e tyre, KIPRED vjen në përfundim se numri i vëzhguesve nuk është në korrelacion të drejtë me parandalimin e keqpërdorimeve në një ambient siç është në Kosovë. Fushatat për vetëdijesimin e popullatës, trajnimi i komisionerëve të zgjedhjeve, riorganizimi i institucioneve që janë bartëse të organizimit të zgjedhjeve, si dhe të gjitha angazhimet tjera për zgjedhje të lira kanë shënuar nivel të ultë të suksesit në parandalimin e manipulimit të zgjedhjeve.

Përfundimisht, përveç KQZ-së, si mekanizmi kryesor përgjegjës, funksionimi i sistemit gjyqësor mbetet një që siguron që të gjitha angazhimet tjera të rezultojnë me sukses ashtu që Kosova të organizoj zgjedhje të lira në të ardhmen.

Kësisoj, KIPRED sheh më se të nevojshme që të analizohet qasja e institucioneve sikurse KQZ, Policia e Kosovës, prokuroritë, dhe gjykatat në hetimin dhe gjykimin e rasteve që ndërliken me procesin e zgjedhjeve në Kosovë. Kjo analizë do të kontribuoj duke paraqitur çështjet shqetësuese që minojnë sistemin e drejtësisë në shqiptimin e dënimeve ndaj personave apo grupeve që kanë qenë të përfshira në manipulimin e votave. Në përfundim të analizës do të paraqiten një sërë rekomandimesh të cilat kërkohet të ndërmerren nga institucionet relevante ashtu që në të ardhmen të kemi një ambient të përshtatshëm për organizim të zgjedhjeve të lira.

3.1. Ankesat e organizatave dhe subjekteve politike në KQZ për zgjedhjet 2010

Gjatë procesit të zgjedhjeve 2010, një numër i organizatave dhe subjekteve politike të cilat ishin të angazhuara në vëzhgimin e procesit zgjedhor kishin paraqitur ankesa rreth këtij procesi tek PZAP. Në mesin e këtyre organizatave/subjekteve politike ndër më aktivët në paraqitjen e ankesave kanë qenë Lëvizja Vetëvendosje me 174 ankesa, Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me 56 ankesa, Aleanca Kosova e Re (AKR) 54 ankesa, Fryma e Re (FER) me 41 ankesa, Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) me 39 ankesa, e kështu me radhë.³⁸ Zyrtarët e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI) insistojnë se kanë arritur të dorëzojnë katër ankesa në PZAP në kuadër të koalicionit të shoqërisë civile “Demokracia në Veprim”.³⁹ Ndërkaq, të dhënat zyrtare të PZAP tregojnë se ky koalicion nuk kishte arritur të paraqiste asnjë ankesë në këtë institucion.⁴⁰ Pa dyshim se të gjitha këto ankesa kanë kontribuar që të dalin në shesh parregullsi të cilat në disa raste kanë rezultuar edhe me përsëritje të votimeve në katër komuna dhe disa qendra votimi. Ndër subjektet më të zhurmshme për procesin zgjedhor dhe manipulimet që e kanë përshkuar atë ka qenë Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), e cila ka kërkuar anulimin e tërësishëm të procesit zgjedhor dhe deri në momentet e fundit ka cilësuar se i gjithë procesi është jo-legjitim.⁴¹ Në bazë të ankesave të paraqitura në KQZ, vërejmë se ky subjekt politik ka dhënë kontribut minimal në drejtim të zbardhjes së të gjitha pretendimeve të pohuara për keqpërdorime në procesin

³⁸ Komunikim i KIPRED-it përmes postës elektronike me Sekretarin e Përhershëm të PZAP-it, z. Mulë Desku, gusht 2011.

³⁹ Komunikim i KIPRED-it përmes telefonit me Drejtorin Ekzekutiv të Institutit Demokratik të Kosovës, z. Ismet Kryeziu, tetor 2011. Po ashtu, Ejupi B., Qavdarbasha Sh. “Zgjedhjet Parlamentare në Kosovë 2010: Vështrim i përgjithshëm dhe trendët”. KIPRED. Prill 2011.

⁴⁰ Komunikim i KIPRED-it përmes postës elektronike me Sekretarin e Përhershëm të PZAP-it, z. Mulë Desku, gusht 2011.

⁴¹ “Kërkon përsëritjen e zgjedhjeve.” Telegrafi. <http://www.telegrafi.com/?id=2&a=11855> (qasur për herë të fundit më 4 tetor 2011).

zgjedhor. Ngjashëm me LDK, edhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) ka paraqitur një numër shumë të vogël të ankesave kundrejt kërkesës për anulimin e të gjithë procesit zgjedhor.⁴² Bazuar në këto pohime dhe denoncime, rezulton se subjektet politike kanë vazhduar me retorikë boshe duke lënë anash kontributin e tyre në drejtim të zbardhjes së procesit zgjedhor, rrjedhimisht drejt ndërtimit të shtetit ligjor.

Partia/Institucioni/Organizata	Numri i ankesave	% nga totali
Lëvizja Vetëvendosje (LVV)	174	38%
Partia Demokratike e Kosovës (PDK)	56	12%
Aleanca Kosova e Re (AKR)	54	12%
Fryma e Re (FER)	41	9%
Rrjeti Ballkanik i Gazetarëve Hulumtues (BIRN)	39	9%
Lidhje Demokratike e Kosovës (LDK)	31	7%
Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK)	19	4%
Të tjera	40	9%
GJITHSEJ	454	100%

Tabela 2 - Numri i ankesave të subjekteve politike dhe organizatave të dorëzuara në PZAP

3.2. Rinumërimi i votave

Zgjedhjet e vitit 2010 janë shoqëruar me një numër të madh të parregullsive dhe manipulimeve duke përfshirë këtu vjedhjet e votave ndërmjet partive dhe ato brenda partive. Ushtruesi i detyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës, njëherësh Kryetar i Kuvendit të Kosovës dhe Sekretar i Përgjithshëm në PDK, z. Jakup Krasniqi, kishte pranuar se vjedhja e votave ka ndodh nga partitë politike.⁴³ Menjëherë pas përfundimit të zgjedhjeve për shkak të keqpërdorimeve është ngritur nevoja që të rinumërohen 40% e votave nga QNR.⁴⁴ Rinumërimi ka rezultuar me sukses në identifikimin e një numri të madh të vendvotimeve ku janë vërejtur manipulimet e zgjedhjeve. QNR ka nxjerrë në pah se gjatë procesit të numërimit të votave për kandidat në një numër të madh të vendvotimeve janë vjedhur votat duke bërë që Formularët e Rezultateve të Kandidatëve (FRK) të mos jenë të vërteta. Këtu përfshihen votat

⁴² “AAK kërkon përsëritjen e zgjedhjeve.” Telegrafi. Shih <http://www.telegrafi.com/?id=2&a=11897> (qasur për herë të fundit më 27 shtator 2011).

⁴³ “Partitë dhunuan vullnetin e qytetarëve”. Telegrafi. Shih <http://www.telegrafi.com/?id=2&a=12094> (qasur për herë të fundit më 27 shtator 2011).

⁴⁴ “Hapen kutitë për rinumërim”. Express. Shih <http://www.gazetaexpress.com/?cid=1,13,43779> (qasur për herë të fundit më 27 shtator 2011).

për kandidatë të cilët kanë marrë më shumë sesa subjekti politik, votat për kandidatë më shumë sesa pesëfishi i votave për subjekt politik, si dhe vota për kandidatë në raste kur subjekti politik nuk ka fituar asnjë votë.⁴⁵ Rezultatet e punës së QNR-së në identifikimin e parregullsive janë paraqitur në tabelën më poshtë.

Numri	Tema	Numri i vendvotimeve	Përshkrimi
1	Manipulime të evidentuara gjatë rinumërimit	890	Vendvotime të rinumëruara të cilat kanë rezultuar me mospërputhje të Formularëve dhe rezultateve reale
2	Manipulime të evidentuara gjatë rinumërimit	712	Vendvotime ku është vërejtur se votat për kandidatë janë manipuluar
3	Manipulime të evidentuara gjatë rinumërimit	178	Vendvotime të cilat konsiderohet se ka pas gabime matematikore
4	Persona të dyshimtë të inkriminuar (712 numri i vendvotimeve x 7 komisionerë)	4,984	Komisionerët përgjegjës për mos përputhje/manipulim të votave të kandidatëve

Tabela 3 - Rastet e manipulimit në Formularët e Rezultateve të Kandidatëve

Në përgjithësi janë vërejtur probleme në 890 vendvotime, ku në 80% të rasteve apo 712 vendvotime janë shtuar numri i votave kandidatëve dhe ka rezultuar me mospërputhje të votave të kandidatëve me votat e partive politike, ndërsa në 20% të rasteve apo 178 vendvotime ka ndodh të ketë gabime të cilat janë më shumë të natyrës matematikore.⁴⁶ Në secilin vendvotim kanë qenë nga shtatë (7) anëtarë të komisionit të cilët kanë qenë përgjegjës për mbarëvajtjen e të gjithë procesit të votimit, numërimit të votave, dhe futjes së të dhënave nëpër formularët të cilët i janë dorëzuar KQZ-së. Bazuar në këto të dhëna del se 4,984 komisionerë të cilët kanë qenë të angazhuar në 712 vendvotime do të duhej të vendoseshin para drejtësisë. Kjo për shkak se vetëm nga procesi i rinumërimit kanë dal në shesh se në të gjitha këto vendvotime ka pas parregullsi që ndërliidhen me vjedhjen dhe shtimin e votave të kandidatëve.⁴⁷ Në të gjitha këto raste ekzistojnë prova të bazuara të cilat do të shërbenin për organet e ndjekjes që të ngritën direkt akuza të drejtpërdrejta, siç edhe është vepruar në një numër rastesh deri tash.

⁴⁵ Vendimi për miratimin e rekomandimeve të QNR-së lidhur me procedurat e numërimit dhe përpilimit të rezultateve për Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, Vendimi numër 1662-2010. Dhjetor 2010.

⁴⁶ Komunikim i KIPRED-it përmes postës elektronike me Drejtorin e QNR-KQZ, korrik 2011. Po ashtu, komunikim i KIPRED-it përmes telefonit me Drejtorin e QNR-KQZ, 25 korrik 2011.

⁴⁷ Sipas Prokurorit të Shtetit deri më tani janë akuzuar rreth 500 persona për veprat penale që kanë të bëjnë me zgjedhjet. Raporti gjashtëmuor, (janar-qershor 2011), lidhur me lëndët që kanë të bëjnë me zgjedhjet e parakohshme parlamentare të mbajtura më 12 dhjetor.

4. KORNIZA LIGJORE PËR NDJEKJEN DHE GJYKIMIN E KRIMEVE TË ZGJEDHJEVE

Korniza ligjore për ndëshkimin e shkelësve, manipuluesve dhe abuzuesve të votave gjatë procesit zgjedhor në Kosovë bazohet në dispozitat ligjore të Kodit Penal të Kosovës. Në pjesën ku përfshihen veprat penale kundër lirive dhe të drejtave të njeriut, gjashtë nene specifike i kushtohen veprave penale që kanë të bëjnë me keqpërdorime të ndryshme të zgjedhjeve.⁴⁸ Baza ligjore për ndjekjen penale nuk kufizohet vetëm në këto vepra por shkon edhe më tutje duke i cilësuar ato në një kategori më të rëndë siç është krimi i organizuar, nëse plotësohen kushtet e caktuara ligjore.

Nenet kryesore që sanksionojnë keqpërdorimet në zgjedhje janë 176, 177, 178, 179, 180, dhe 181 të Kodit Penal të Kosovës. Përmes këtyre veprave penale dënohen të gjithë personat të cilët në çfarëdo mënyre pengojnë votuesit që të ushtrojnë të drejtën e votës, që ndërmarrin çfarëdo veprimtarish korruptive apo përdorin dhunë në ditën e votimit, votojnë disa herë të njëjtit votues, zbulojnë votën e fshehtë, mashtrojnë në votime dhe asgjësojnë në forma të ndryshme dokumentet e votimit. Mashtrimi me votën konsiderohet edhe si krim i rëndë ku dënimet përfshijnë shqiptimin e gjobave, dënimet me kusht, dhe dënimet me burg deri në pesë vite. Pra, korniza ligjore nuk ka mangësi në këtë aspekt, pasi sanksionon pothuajse të gjitha llojet e keqpërdorimeve që janë bërë deri më tash në zgjedhjet e mbajtura në Kosovë. Megjithatë, efektiviteti i ligjeve varet kryekëput nga zbatimi i tyre. Në vazhdim do paraqesim një tabelë e cila përmban të gjitha dispozitat që dënojnë krimet e zgjedhjeve.

Neni	Vepra penale	Përshkrimi	Dënimi
176	Parandalimi i ushtrimit të së drejtës së votimit	<i>Kushdo që gjatë ushtrimit të detyrave që i besohen atij lidhur me votimet në Kosovë dhe me qëllim të pengimit të ushtrimit të së drejtës së votimit të personit tjetër në mënyrë të paligjshme nuk e regjistron personin e tillë në listën e regjistrimit të votuesve ose në ndonjë mënyrë tjetër e pengon personin tjetër nga ushtrimi i të drejtës së votës dënohet me gjobë apo me burgim deri në një vit</i>	Min: Gjobë Max: 1 vit burg
177	Cenimi i përcaktimit të lirë të votuesve	<i>Kushdo që me përdorimin e dhunës, kanosjes serioze, rryshfetit ose duke keqpërdorur varësinë ekonomike apo profesionale të votuesit ndikon në votuesit në Kosovë që të votojnë në mënyrë të caktuar ose të mos votojnë në zgjedhje dënohet me burgim prej gjashtë muajve deri në tre vjet</i>	Min: gjashtë muaj burg Max: 3 vjet burg

⁴⁸ Kapitulli XVI: “Veprat penale kundër lirive dhe të drejtave të njeriut”, Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës, 6 prill 2004;

178	<i>Keqpërdorimi i të drejtës së votimit</i>	<i>Kushdo që në zgjedhjet e mbajtura në Kosovë voton në emër të personit tjetër ose voton, apo megjithëse ka votuar, sërish tenton të votojë, dënohet me dënim me gjobë a me burgim deri në një vit</i>	Min: gjobë Max: 1 vit burg
179	<i>Cenimi i fshehtësisë së votimit</i>	<i>(1) Kushdo që në zgjedhje të mbajtura në Kosovë cenon fshehtësinë e votimit dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë muaj.</i> <i>(2) Kushdo që me përdorimin e dhunës, kanosjes serioze ose në ndonjë mënyrë tjetër kërkon nga personi të tregojë se për cilin ka votuar dënohet me gjobë apo me burgim deri në një vit.</i> <i>(3) Nëse veprën penale nga paragrafi 1 i këtij neni e kryen anëtari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ose cilido person tjetër gjatë ushtrimit të detyrës së tij gjatë zgjedhjeve a votimit, kryerësi dënohet me burgim deri në tre vjet.</i>	Min: gjobë Max: 3 vjet burg
180	<i>Mashtrimi në votime</i>	<i>Kushdo që i falsifikon rezultatet e zgjedhjeve apo të votimeve në Kosovë duke shtuar, hequr apo shlyer votat a nënshkrimet, duke i numëruar në mënyrë jo të saktë, duke i regjistruar në mënyrë jo të saktë rezultatet e zgjedhjeve në dokumentet zgjedhore apo këtë e kryen në ndonjë mënyrë tjetër ose i publikon rezultatet e zgjedhjes a të votimit që nuk i përgjigjen votimit të kryer dënohet me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet</i>	Min: gjashtë muaj burg Max: 5 vjet burg
181	<i>Asgjësimi i dokumenteve të votimit</i>	<i>(1) Kushdo që në zgjedhjet e mbajtura në Kosovë fsheh, dëmton apo e merr ndonjë dokument lidhur me zgjedhjet dënohet me gjobë apo me burgim deri në një vit.</i> <i>(2) Nëse veprën nga paragrafi 1 i këtij neni e kryen personi zyrtar në ushtrimin e detyrës në lidhje me zgjedhjet, kryerësi dënohet me burgim deri në dy vjet</i>	Min: gjobë Max: 2 vjet burg

Tabela 4 - Veprat penale që ndërlidhen me zgjedhjet në Kosovë

5. DËMET E MANIPULIMEVE TË ZGJEDHJEVE

Veprimtaritë e shumta të kundërligjshme të manifestuara përmes krimeve të zgjedhjeve kanë rezultuar me dëme të mëdha dhe të llojlojshme. Padyshim se këto fenomene negative krijojnë dilema të shumta rreth qëllimit fundamental të procesit zgjedhor. Shkalla e lartë e vjedhjes së votave⁴⁹ shtron dyshime nëse votat e popullit janë përkthyer në të zgjedhur të merituar apo në Kuvendin e Kosovës janë futur anëtarë të cilët janë produkt i votave të manipuluar. Anëtarët të cilët votat e tyre i kanë siguruar në mënyrë të kundërligjshme ka pak gjasa të ndjejnë nevojën për t'i dhënë llogari qytetarëve për punën e tyre në Kuvend. Këta persona sigurisht që llogari i japin vetëm ndaj protagonistëve të cilët kanë kontribuar në sigurimin e një ulëseje në Kuvend, duke dëmtuar kështu rëndë njërin nga parimet e çmuara të demokracisë që është llogaridhënia ndaj qytetarëve.

Dëmet në kurriz të qytetarëve janë reflektuar në disa aspekte. Pikë së pari, qytetarët humbin kohën e vlefshme për shkak të detyrimit të tyre për të dalë në votim disa herë për të zgjedhur përfaqësuesit e tyre, këtë me fajin e manipuluesve. Së dyti, çdo keqpërdorim i votës përkthehet në humbje të besimit të qytetarëve në proceset zgjedhore. Së treti, organizimi i rivotimit bartë implikime buxhetore të cilat bien mbi supe të taksapaguesve. Së katërti, rastet e dërguara në gjykata dhe prokurori, rëndojnë këto institucione edhe ashtu të stërngarkuara me një numër enorm të lëndëve të pazgjdhura. Procesi zgjedhor për Kuvendin e Kosovës i mbajtur në dhjetor 2010 dhe janar 2011 ka përfshi numër të madh të keqpërdorimeve në disa nivele duke përfshirë dështimin e funksionimit të mjeteve themelore që sigurojnë mbarëvajtjen e procesit të votimit,⁵⁰ vjedhjen ekstreme të votave gjatë votimit,⁵¹ si dhe manipulimin e numrit të votave të shënuara në formularët e numërimit.⁵² Shkalla e lartë e keqpërdorimeve është reflektuar në pasoja tejet të mëdha të cilat i ka bartur dhe vazhdon t'i bartë shoqëria në Kosovë. Përfundimisht, niveli i lartë i keqpërdorimeve ka zhytur vendin në një krizë institucionale e cila ka zgjatur për disa muaj⁵³ duke lënë prapa procese shumë të

⁴⁹ Shkallën e lartë e manipulimeve është dokumentuar në forma të ndryshme nga një numër i madh i burimeve. Shih "Kosovo election prompts EU observer fraud claims". BBC. Gjendet në <http://www.bbc.co.uk/news/world-europe-11986105> (qasur për herë të fundit më 27 shtator 2011). Po ashtu, vendimet e KQZ-së për miratimin e rekomandimeve të Qendrës për Numërim dhe Rezultate për rinumërim të fletëvotimeve. Po ashtu, Ejupi B., Qavdarbasha Sh. "Zgjedhjet Parlamentare në Kosovë 2010: Vështrim i përgjithshëm dhe trendët". KIPRED. Prill 2011.

⁵⁰ Sipas Demokracisë në Veprim, në shumë vendvotime nuk kanë funksionuar llambat ultravjollce si dhe ngjyra e padukshme. Komunikatë për media. Demokracia në Veprim. Shih http://www.demokracianeveprim.org/al/printo.php?subaction=shoëfull&id=1292337622&archive=&start_from=&ucat=& (qasur për herë të fundit më 26 shtator 2011).

⁵¹ Ambasadori Amerikan në Kosovë Kristofer Dell kishte vëzhguar aso parregullsi ku numri i fletëvotimeve kishte tejkaluar numrin e nënshkrimeve. Shih "Kosovo election prompts EU observer fraud claims". BBC. Gjendet në <http://www.bbc.co.uk/news/world-europe-11986105> (qasur për herë të fundit më 27 shtator 2011).

⁵² Një gjë e tillë konfirmohet nga KQZ dhe QNR, pasi që rinumërimi i fletëvotimeve është bërë pasi që janë konstatuar se numri i votave për kandidat ka tejkaluar për pesë herë numrin e për subjektin politik, kandidatët kanë marrë vota më shumë se subjekti politik, dhe raste ku subjekti nuk ka fituar vota por kandidati ka fituar vota. Vendimi për miratimin e rekomandimeve të QNR-së për rinumërimin e fletëvotimeve nga vendvotimet e caktuara të zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës me 9 janar 2011, Vendimi numër 88-2011. Janar 2011. Po ashtu, Vendimi për miratimin e rekomandimeve të QNR-së lidhur me procedurat e numërimit dhe përpilimit të rezultateve për Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, Vendimi numër 1662-2010. Dhjetor 2010.

⁵³ Kuvendi i Kosovës është shpërbërë me 2 nëntor 2010 pas votimit të mocionit të mosbesimit ndaj Qeverisë duke i hapur rrugë zgjedhjeve të jashtëzakonshme. Ndërsa, Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Presidenti janë zgjedhur tek më 22 shkurt 2011, plotë katër muaj pas shpërbërjes. Shpërbëhet Kuvendi i Kosovës. Shih <http://www.assembly-kosova.org/?cid=1,128,3502> (qasur për herë të fundit më 27 shtator 2011). Po ashtu, Kuvendi zgjodhi Presidentin dhe Qeverinë e Republikës së Kosovës. Shih <http://www.assembly-kosova.org/?cid=1,128,3517> (qasur për herë të fundit më 27 shtator 2011).

rëndësishme dhe duke kufizuar kapacitetet e institucioneve për të ofruar shërbime për qytetarët qoftë në nivelin qendror apo atë lokal.

Dëmet e zgjedhjeve kanë shkaktuar dëme financiare në aspekte të ndryshme përfshirë shpenzimet shtesë për riorganizim të votimeve. Sekretariati i KQZ-së ishte detyruar që të riorganizonte votimin në 185 vendvotime më 9 janar 2011 dhe në 126 vendvotime më 23 janar 2011.⁵⁴ Për procesin e rivotimit u angazhuan 2,887 anëtarë shtesë të KVV-ve, të cilët i kushtuan buxhetit të KQZ-së plotë 212,902 Euro.⁵⁵ Në përgjithësi, procesi i rivotimit dhe rinumërimit ka rezultuar me shpenzime prej mbi 674 mijë Eurove.⁵⁶ Dëmet e zgjedhjeve patjetër se janë reflektuar edhe në pakënaqësi në shoqërinë kosovare, mirëpo adresimi i problemit është manifestuar përmes shprehjes së pakënaqësive në formë të retorikës politike pa prodhuar pasoja juridike për manipuluesit. Shoqëria kosovare në forma të ndryshme publikisht ka dënuar parregullsitë që kanë përshkuar këto zgjedhje, ku ndër aktivitetet e tjera një grup i aktivistëve, politikanëve, dhe qytetarëve me këtë rast kishin shpallur se procesi zgjedhor kishte degraduar deri në atë shkallë sa kishte mbytur demokracinë në vend.⁵⁷ Megjithatë, ka munguar ndonjë reagim i fuqishëm i organizatave, subjekteve politike, apo aktivistëve të shoqërisë civile sa i përket ndjekjes penale të atyre të cilët mashtruan në votime dhe manipuluan rezultatet e zgjedhjeve.⁵⁸ Ankesat dhe mllefi për manipulime gjithnjë i është drejtuar anëtarëve të Kuvendit të Kosovës dhe elitës politike, por ka pasur mungesë të ndonjë reagimi i cili i drejtohet organeve të drejtësisë për të kërkuar që të shqiptohen dënimet meritore për manipuluesit e zgjedhjeve.

Organet e drejtësisë kohë pas kohe kanë publikuar informata për publikun e gjerë rreth trajtimit të lëndëve të zgjedhjeve nga prokuroritë dhe gjykatat. Debati publik gjatë tërë kohës ka munguar madje edhe në rastet kur janë publikuar të dhënat nga organet e drejtësisë kjo temë ka kaluar pa ndonjë trajtim të cilin e meriton.⁵⁹ Komisioni për amendamentim të Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës ka mbajtur mbledhje në të cilën janë diskutuar sanksionet penale që janë shqiptuar ndaj kryerësve të veprave penale gjatë procesit të zgjedhjeve.⁶⁰ Anëtarët e këtij Komisioni, Kryeprokurori i Shtetit, Kryetari i Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) janë shprehur të pakënaqur me dënimet e shpallura nga organet

⁵⁴ Raporti i Shpenzimeve për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës 2010. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Shkurt 2011.

⁵⁵ Po aty.

⁵⁶ Po aty.

⁵⁷ Në protestën paqësore të organizuar më 18 dhjetor 2010 para Teatrit Kombëtar në Prishtinë, dhjetëra aktivistëve të shoqërisë civile, politikan, dhe qytetarë të tjerë kanë ndezur qirinj me moton "Të ndezim qirinj për demokracinë e vdekur".

⁵⁸ Lëvizja Vetëvendosje kishte organizuar një protestë me moton "Kundër hajnisë", e cila përmbante disa brenga të ngritura sa i përket hajnisë e ndër këto çështje ishte edhe shqetësimi për manipulimin e zgjedhjeve. Sipas zyrtarëve të Lëvizjes Vetëvendosje në këtë protestë kishin marrë pjesë rreth 10,000 qytetarë, ndërsa në bazë të Policisë së Kosovës kësaj proteste ju kishin bashkangjitur rreth 2,000 persona. Shih *VV:Ndërtesa e Qeverisë, VIP pavijoni i Dubravës*. Portali Zëri Info. Gjetet në <http://www.zeri.info/artikulli/1/1/28523/policia-ia-heqe-skenen-vetevendosjes/> (qasur për herë të fundit më 18 gusht 2011). Po ashtu, komunikim i KIPRED-it përmes postës elektronike me Sekretariatit për Media dhe Komunikim, Lëvizja Vetëvendosje, gusht 2011.

⁵⁹ Gjatë muajit korrik 2011, Prokuroria e Shtetit dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës kanë njoftuar publikun rreth mbarëvajtjes së procesit të hetimit dhe dënimit të atyre që manipuluan zgjedhjet. Të gjitha mediat kanë mbuluar këtë lajm megjithatë nuk është ndezur ndonjë debat më i gjerë në shoqëri apo ndonjë raportim hulumtues sa i përket ndjekjes së manipuluesve.

⁶⁰ Në këtë mbledhje të Komisionit pika kryesore e Rendit të ditës ishte diskutimi për sanksionet penale që janë shqiptuar ndaj kryerësve të veprave penale gjatë procesit zgjedhor dhe problemet që janë identifikuar gjatë procesit të zgjedhjeve. Në mbledhje për diskutim ishin ftuar anëtarët e Komisionit, Kryeprokurori i Shtetit, si dhe përfaqësues të Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Sertolli F., "Gjykatat amnistuan hajnat e votave." Zëri Info. Shtator 2011. Shih <http://www.zeri.info/artikulli/1/1/33123/gjykatat-amnistuan-hajnat-e-votave/> (qasur për herë të fundit më 27 shtator 2011).

gjyqësore ndaj manipuluesve të zgjedhjeve.⁶¹ Kjo mbledhje e Komisionit Parlamentar duhet të shërbente që anëtarët e Parlamentit të Kosovës të kuptojnë se dënimet e ulëta kërcënojnë çdo iniciativë tjetër e cila është duke u ndërmarrë në përmirësimin e procesit të zgjedhjeve në Kosovë. Tërë këto dëme të njëpasnjëshme dhe mungesa e një përgjigje adekuate nga drejtësia për këto fenomene, medoemos se kanë ndikuar edhe në imazhin e Republikës së Kosovës në arenën ndërkombëtare,⁶² ku zgjedhjet gjithmonë shërbejnë si matës për zhvillimin e demokracisë së një vendi. Ky dëm i madh për imazhin e shoqërisë dhe shtetit të Kosovës ka ardhur pikërisht pas investimeve prej 5.7 milionë eurove të bëra nga Qeveria për promovimin e vendit përmes fushatës “Kosovo, the young europeans”.⁶³ Andaj, manipulimi i votave dhe parregullsitë në procesin zgjedhor kanë efekte shumë dimensionale të dëmshme.

⁶¹ Po aty.

⁶² Artikuj të ndryshëm ishin publikuar në mediat prestigjioze ndërkombëtare menjëherë pas përfundimit të procesit zgjedhor në Kosovë, përfshi këtu The Economist, The Guardian, BBC, The Telegraph, RTE News, Deutsche Welle, dhe shumë media tjera ndërkombëtare. Artikujt e këtyre medieve të cilët kanë shtjelluar parregullsitë zgjedhore gjinden në këto linqe: 1) Lewis P., “Kosovo election fraud suspicions undermine PM’s victory claim.” The Guardian. Shih <http://www.guardian.co.uk/world/2010/dec/13/kosovo-election-fraud-claims> (qasur për herë të fundit më 27 shtator 2011). 2) Day M., “Kosovo election marred by fraud allegations”. The Telegraph. Shih <http://www.telegraph.co.uk/news/worldnews/europe/kosovo/8199269/Kosovo-election-marred-by-fraud-allegations.html> (qasur për herë të fundit më 27 shtator 2011). 3) Calm now, a storm to come?. The Economist. Shih http://www.economist.com/blogs/easternapproaches/2010/12/kosovos_election (qasur për herë të fundit më 27 shtator 2011). 4) Kosovo election prompts EU observer fraud claims. BBC. Shih <http://www.bbc.co.uk/news/world-europe-11986105> (qasur për herë të fundit më 27 shtator 2011). 5) Kosovo election marred by fraud allegations. RTE News. Shih <http://www.rte.ie/news/2010/12/13/kosovo.html> (qasur për herë të fundit më 27 shtator 2011). 6) Kosovo PM’s party wins majority amid complaints of fraud. Deutsche Welle. Shih <http://www.dw-world.de/dw/article/0,,6325414,00.html> (qasur për herë të fundit më 27 shtator 2011).

⁶³ Veliu E., Hamidi L. “Milionë për mbrojtje të Kosovës apo të Qeverisë”. Zëri Info. Shih <http://www.zeri.info/artikulli/2/8/11406/miliona-per-mbrojtje-te-kosoves-apo-te-qeverise/> (qasur për herë të fundit më 27 shtator 2011).

6. ROLI DHE EFIKASITETI I PROKURORIVE KOMUNALE

Duke parë injorimin e organeve të drejtësisë në ndjekjen dhe gjykimin e rasteve të manipulimit të zgjedhjeve të vitit 2007, individë dhe grupe të caktuara në një apo mënyrë tjetër janë stimuluar të rrisin intensitetin e aktiviteteve manipuluese në proceset e ardhshme zgjedhore të organizuara në vitet 2009 dhe 2010. Ky trend i manipulimeve në njërin anë dhe i mosndëshkimit në anën tjetër kanë detyruar Prokurorin e Shtetit dhe Gjykatën Supreme që këto lëndë t'i trajtojnë si lëndë prioritare.⁶⁴ Në të gjitha zgjedhjet e deritashme shkalla më e lartë e keqpërdorimeve dhe manipulimeve është shënuar në zgjedhjet e përgjithshme të mbajtura në vitin 2010 dhe procesin e rivotimit të organizuar në janar 2011. Prokurori i Shtetit ka krijuar një task forcë të cilën e udhëheq vetë në koordinim me të gjithë prokurorët e Prokurorive Komunale në të cilat gjenden lëndët e zgjedhjeve.⁶⁵ Prokurori i Shtetit ka pranuar raste të cilat janë trajtuar nga PZAP dhe QNR, të dyja këto organe të KQZ-së. Lëndët janë ndarë nëpër prokuroritë komunale përkatëse dhe është kërkuar që të grumbullohen prova të mëtutjeshme dhe të ngritën aktakuza nëpër gjykata. Prokuroritë komunale nga gjithsejtë 239 raste sa kanë pranuar në punë, kanë akuzuar 377 persona ndaj të cilëve janë ngritur akuza dhe propozim akuza, dhe për zgjedhjet e vitit 2010, deri më tani janë shpallur vetëm 12 aktgjykime.⁶⁶

Prokuroria Publike Komunale	Numri i lëndëve të pranuara	Ngritja e akuzave		Propozim akuzat		Hudhja e kallëzimeve penale	Rastet e mbyllura	AKTGJYKIMET
		Numri i rasteve	Numri i personave	Numri i rasteve	Numri i personave			
Prishtinë	87	19	137	19	162	7	18	5
Gjilan	8	0	0	3	4	4	2	1
Ferizaj	34	9	47	0	0	2	0	4
Gjakovë	2	2	2	0	0	0	0	2
Mitrovicë	55	0	0	10	13	12	0	0
Prizren	28	0	0	3	3	5	0	0
Pejë	25	2	8	1	1	17		0
TOTAL	239	32	194	36	183	47	20	12

Tabela 5 - Efikasiteti i Prokurorive Publike Komunale për rastet e zgjedhjeve

⁶⁴ Intervistat e KIPRED-it me Kryetarin e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, z. Fejzullah Hasani, gusht 2011, dhe Kryeprokuroren e Shtetit, z. Ismet Kabashi, korrik 2011.

⁶⁵ Intervistë e KIPRED-it me Prokuroren e Prokurorit të Shtetit dhe Koordinatorin për lëndët e zgjedhjeve, znj. Laura Pula, korrik 2011.

⁶⁶ Raporti gjashëmujor, (janar-qershor 2011), lidhur me lëndët që kanë të bëjnë me zgjedhjet e parakohshme parlamentare të mbajtura më 12 dhjetor.

Pjesa dërmuese e dënimeve janë me gjobë, ndërsa disa prej tyre janë me disa muaj burgim efektiv.⁶⁷ Për të gjitha këto vendime, Prokurori i Shtetit ka vendosur të ankohet në të gjitha aktgjykimet.⁶⁸ Ky është një hap i drejtë i Prokurorit të Shtetit bazuar në këto dënime tejet të ulëta të shqiptuara nga gjykatat krahasuar me dëmet e shkaktuara. Megjithatë, nëse analizohet kontributi i prokurorëve në këto raste, vërehet se ata nuk janë treguar të efektshëm në hetimin e të gjitha veprimeve kriminale të zgjedhjeve, të cilat do të mund të zbulonin ndonjë ndërmarrje të përbashkët kriminale, bazuar në numrin enorm të vjedhjeve dhe personave të përfshirë në to. Prokurorët në këto raste janë mjaftuar vetëm me materialet e gatshme të cilat janë pranuar nga PZAP. Duke ditur rolin e prokurorëve në mbrojtje të interesit publik pa dyshim se ata kanë dështuar në trajtimin e drejtë të këtyre rasteve. Hezitimi i tyre i vazhdueshëm në ndjekje efikase dhe të duhur ka rezultuar në rritje të kriminalitetit të zgjedhjeve ndër vite.

6.1. Ngritja e aktakuzave të drejtpërdrejta

Dosjet e pranuar nga QNR në të cilat specifikohen manipulimet që janë bërë gjatë nxjerrjes së rezultateve për kandidatët për Kuvendin e Kosovës kanë lehtësuar punën e prokurorive publike e cila në të shumtën e rasteve ka rezultuar me ngritjen aktakuzave të drejtpërdrejta. Deri më tash, nga 18 raste ku janë ngritur aktakuza të drejtpërdrejta janë akuzuar 125 persona.⁶⁹ Prokuroritë Publike Komunale aktualisht janë duke shqyrtuar 174 raste shtesë me raporte preliminare në të cilat përfshihen 1,217 persona zyrtarë.⁷⁰ Provat e pakontestuara të siguruara nga QNR gjatë procesit të rinumërimit të votave kanë shtyrë Prokurorin e Shtetit që të shkojë në ngritjen e drejtpërdrejtë të akuzave. Gjetjet e QNR-së përmbajnë fakte për heqjen dhe shtimin e votave për kandidatët, duke vërtetuar saktë manipulimet me vota. Parregullsi të tilla nga QNR janë identifikuar në 712 vendvotime/raste, ku secili rast përfshinë nga shtatë komisionerë, që i bie se prokuroritë komunale duhet të ngritin aktakuza kundër rreth 5,000 personave zyrtarë të përfshirë në procesin e manipulimit të zgjedhjeve.⁷¹ Në tabelën 6 është paraqitur efikasiteti i prokurorive në zgjidhjen e lëndëve të cilat ndërlidhen me akuza të drejtpërdrejta.

⁶⁷ Intervistë e KIPRED-it me Prokuroren e Prokurorit të Shtetit dhe Koordinatorin për lëndët e zgjedhjeve, znj. Laura Pula, korrik 2011. Po ashtu, intervistë e KIPRED-it me Kryeprokurorin e Shtetit, z. Ismet Kabashi, korrik 2011.

⁶⁸ Po aty.

⁶⁹ Raporti gjyqësor, (janar-qershor 2011), lidhur me lëndët që kanë të bëjnë me zgjedhjet e parakohshme parlamentare të mbajtura më 12 dhjetor.

⁷⁰ Po aty.

⁷¹ Ky numër është nxjerrë në bazë të të dhënave nga QNR rreth vendvotimeve ku janë konstatuar parregullsi në formularët e plotësuar nga komisionerët. Komunikim i KIPRED-it përmes telefonit dhe postës elektronike me Koordinatorin e Qendrës së Numërimit dhe Rezultateve, z. Burim Ahmetaj, korrik 2011.

Prokuroria Publike Komunale	Aktakuza të drejtpërdrejta			
	Raporte preliminare		Aktakuza të ngritura direkt	
	Numri i rasteve	Numri i personave	Numri i aktakuzave	Numri i personave
Prishtinë	70	490	0	0
Gjilan			0	0
Ferizaj	34	238	0	0
Gjakovë	11	76	11	76
Mitrovicë			0	0
Prizren	59	413	7	49
Pejë			0	0
TOTAL	174	1217	18	125

Tabela 6 - Ngritja e aktakuzave të drejtpërdrejta nga prokurorët

Nëse vazhdon praktika e njëjtë e ngritjes së aktakuzave të drejtpërdrejta, atëherë në proces përveç 174 rasteve të gatshme me raporte preliminare, tanimë të deklaruar nga prokuroritë publike sikur raste në përpunim, duhet të shtohen edhe 538 raste tjera të cilat do të kompletin numrin e përgjithshëm të rasteve të proceduara nga QNR në 712 raste të manipulimeve të tilla. Prandaj, raportet preliminare me fakte të pakontestueshme për manipulim të votave ku përfshihen në secilin vendvotim nga shtatë komisionerë, do të duhej të shërbenin për prokurorët që të hetojnë bashkëpunimin kriminal që ka ekzistuar ndërmjet tyre në këtë numër kaq të madh.

7. ANGAZHIMI I GJYKATAVE NË ZGJIDHJEN E LËNDËVE

Ngritja e pjesës më të madhe të akuzave ndaj personave të përfshirë në manipulime është bërë kryesisht sipas nenit 180 të Kodit Penal të Kosovës, i cili njihet si “mashtime në votime”. Nga gjashtë veprat penale të këtij Kodi që ndërlidhen me keqpërdorimet në zgjedhje, dënimet më të ashpra janë ato për veprën penale të mashtimeve në votime. Kryesit e kësaj vepre mund të dënohen nga gjashtë muaj deri në pesë vite burgim. Sipas KGJK-së, për veprën penale të mashtimeve në votime janë akuzuar 300 persona. Në rast se këta persona dënohen me burgim efektiv prej vetëm gjashtë muajve atëherë do të kishim 150 vjet burg të shqiptuar ndaj tyre.

NENI	177		178		179		180	
	raste	persona	raste	persona	raste	persona	raste	persona
Gjilan							6	12
Kamenicë	1	2					4	8
Viti							2	2
Prizren	1	1						
Dragash	1	1						
Pejë							1	3
Gjakovë			1	1			12	77
Prishtinë			8	8	1	2		
Ferizaj							4	18
Shtërpcë							3	9
Glllogovc							20	128
Kacanik							4	24
Lypjan			1	1			1	14
Skenderaj			1	2			5	5
Vushtrri			1	1				
TOTAL	3	4	12	13	1	2	62	300

Tabela 7 - Aktakuzat e konfirmuara nga gjykatat sipas veprave penale

Gjykata Supreme ka vendosur që lëndët e zgjedhjeve t'i trajtojë me prioritet dhe që dënimi për këta kryes të arrij efektin e vetë juridik. Deri më tash dënimet e shqiptuara janë minimale, përkatësisht janë dënime me gjobë dhe me kusht. Gjykatësit me rastin e shqiptimit të dënimeve më të ulëta të mundshme, të cilat janë vendosur nga ligjvënësit në Kodin Penal të Kosovës, kanë zgjedhur që manipuluesit e zgjedhjeve të kalojnë sa më lehtë që është e mundur, rrjedhimisht me apo pa qëllimin e tyre sikurse edhe në të kaluarën po ndikojnë në stimulimin e kryerjes së këtyre veprave penale.

7.1. Efikasiteti i gjykatave në zgjidhjen e lëndëve

Gjykatat dhe prokuroritë nuk po arrijnë kurrësi që të krijojnë ndonjë platformë për të përcjellë progresin e zgjidhjes së lëndëve. Ky problem ka lënë gjurmë edhe në procedimin e lëndëve të zgjedhjeve, ku përkundër shpalljes së këtyre lëndëve si prioritare, as KGJK apo Gjykata Supreme si dhe Prokurori i Shtetit nuk po arrijnë të sigurojnë ndonjë pasqyrë të qartë të progresit në zgjidhjen e këtyre lëndëve. Secila prej këtyre institucioneve posedon statistika që bien në kundërshtim njëra me tjetrën, rrjedhimisht nuk mund të vlerësohet progresi apo regresi i saktë në zgjidhjen e këtyre lëndëve. Sa për ilustrim, mungesa e koordinimit institucional Prokurori i Shtetit dhe KGJK paraqitet në paqartësinë rreth numrit të aktakuzave të ngritura ku prokurorët deklarojnë se janë gjithsejtë 239 raste, ndërsa gjykatat komunale deklarojnë vetëm 78 raste. Megjithatë, në vazhdim analiza do të mbështetet në të dhënat që janë siguruar nga KGJK dhe janë futur në një bazë të të dhënave për të nxjerrë statistika të trendit të zgjidhjes së këtyre lëndëve dhe për t'i analizuar ato në detaje.

GJYKATA KOMUNALE:	Numri i lëndëve	Numri i personave të akuzuar	Lënda e Zgjidhur	Persona në lëndë të zgjidhura	Progresi në zgjidhjen e rasteve	Progresi në zgjidhjen e rasteve në bazë të personave
Gjilan	6	12	1	2	17%	17%
Kamenicë	5	10	2	4	40%	40%
Viti	2	2	0	0	0%	0%
Prizren	1	1	1	1	100%	100%
Dragash	1	1	0	0	0%	0%
Pejë	1	3	0	0	0%	0%
Gjakovë	13	78	1	1	8%	1%
Prishtinë	9	10	2	2	22%	20%
Ferizaj	4	18	4	18	100%	100%
Shtërpcë	3	9	2	8	67%	89%
Glllogovc	20	128	13	77	65%	60%
Kaçanik	4	24	1	3	25%	13%
Lypjan	2	15	1	1	50%	7%
Skenderaj	6	7	1	1	17%	14%
Vushtrri	1	1	1	1	100%	100%
TOTAL:	78	319	30	119	38%	37%

Tabela 8 - Progresi në zgjidhjen e lëndëve të zgjedhjeve

Zgjidhja e lëndëve të zgjedhjeve nuk është bërë në përputhje me qarkoren e nxjerrë nga Gjykata Supreme e Kosovës, e cila i obligon Gjykatat Komunale që ato t'i trajtojnë si prioritet mbi prioritetet.⁷² Shqetësues mbetet trajtimi i këtyre rasteve nga gjykatësit, të cilët nuk kanë shënuar rezultate të pritshme në zgjidhjen e këtyre lëndëve, ku deri më tani as

⁷² Gjykata Supreme e Kosovës ka nxjerrë një qarkore, përmes së cilës ka vendosur që lëndët e zgjedhjeve t'i trajtojnë me prioritet të plotë. Intervista e KIPRED-it me kryetarin e Gjykatës Supreme të Kosovës, z. Fejzullah Hasani, gusht 2011.

gjysma e tyre nuk janë zgjidhur.⁷³ Nga 319 persona të akuzuar për përfshirje në manipulime të zgjedhjeve, gjykatësit kanë shqiptuar dënime ndaj 119 prej tyre.⁷⁴ Drejtuesit e Prokurorit të Shtetit, KGJK-së dhe Gjykatës Supreme mbështetur në qarkoret e tyre për t'i trajtuar me prioritet këto lëndë janë shprehur të pakënaqur me numrin e rasteve të zgjidhura deri më tash.⁷⁵ Në një mënyrë zvarritja dhe mospërfillja e prioriteteve të shpallura është dekurajuese duke zbehur pritjet e opinionit dhe përpjekjet për të dënuar manipuluesit e zgjedhjeve.

Një praktikë tashmë e instaluar në fjalorin e drejtuesve të sistemit të drejtësisë në vend, ka filluar të ngjajë në retorikën politike. Vendimet dhe deklaratimet e tyre për zgjidhjen e një sërë çështjeve me rëndësi për shoqërinë kosovare kanë filluar të trajtohen me mungesë serioziteti dhe përgjegjshmërie. Përgjegjësit për dështimet e përgjithshme përfshirë këtu edhe të gjithë mekanizmat institucional për organizimin dhe mbarëvajtjen e procesit zgjedhor, do duhej të merrnin dënimet e merituar nga drejtësia në vend, në një afat sa më të shkurtër kohor dhe të arsyeshëm ligjor, duke pasur parasysh edhe trajtimin prioritar të vendosur për zgjidhjen e këtyre lëndëve.

Veprimi i deritashëm, dëshmon për një papërgjegjësi të gjykatësve komunal, të cilët nuk janë përgjigjur si duhet në thirrjet e drejtuesve të gjyqësorit për trajtimin e këtyre lëndëve me prioritet.⁷⁶ Arsyeja se pse një numër i lëndëve nuk është zgjidhur nga gjykatësit, qëndron në faktin se ngritja e aktakuzave në këto raste është bërë sa për sy e faqe. Kjo ka ndodhur për shkak të tendencës së prokurorëve për të ngritur një numër sa më të madh të aktakuzave, në mënyrë që t'i përgjigjen urdhrin të Prokurorit të Shtetit për trajtim urgjent të zgjidhjes së lëndëve të zgjedhjeve.⁷⁷ Kjo është e patolerueshme për etikën profesionale të prokurorëve të cilët pranojnë të bëjnë punën shkel e shko. Efekti negativ i kësaj pune do të rezultojë me dështim të zbardhjes së rasteve të manipulimit të zgjedhjeve.

Që nga përfundimi i luftës në sistemin gjyqësor të Kosovës, nuk kanë ekzistuar mekanizma të kontrollit të punës për gjykatësit dhe prokurorët. Ky sindrom ka vazhduar edhe në rastin e lëndëve të zgjedhjeve. Asnjë mekanizëm kontrolli nuk është krijuar për të vëzhguar trendin e zgjidhjes së këtyre rasteve. Përkundër zotimit të Kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës se lëndët për zgjedhjet 2007 dhe 2009 do të zgjidheshin brenda dy muajve në shkallë të parë,⁷⁸ një gjë e tillë nuk ka ndodhur. Kjo flet për një papërgjegjësi të krerëve të gjyqësorit dhe sidomos vartësve të tyre, njëherësh përgjegjës kryesor për zgjidhjen e lëndëve, të cilët janë treguar të papërfillshëm në zbatimin e prioriteteve dhe ndarjen e drejtësisë në kohë të bazuar në dispozita ligjore për gjykim të drejtë dhe të arsyeshëm.

⁷³ Shih tabelën 9, në rubrikën “Progresi në zgjidhjen e rasteve”, në të gjitha gjykatat komunale vetëm 38 % e lëndëve del se janë zgjidhur.

⁷⁴ Po aty.

⁷⁵ Intervista e KIPRED-it me kryetarin e Gjykatës Supreme të Kosovës, z. Fejzullah Hasani, gusht 2011. Po ashtu, intervista e KIPRED-it me Kryeprokurorin e Shtetit, z. Ismet Kabashi, korrik 2011. Po ashtu, intervista e KIPRED-it me Kryesuesin e KGJK-së, z. Enver Peci, korrik 2011.

⁷⁶ Madje, as kreu i Gjykatës Supreme të Kosovës, nuk e ka të qartë se pse një pjesë e madhe e këtyre lëndëve nuk janë zgjidhur deri më tash. Intervista e KIPRED-it me kryetarin e Gjykatës Supreme të Kosovës, z. Fejzullah Hasani, gusht 2011.

⁷⁷ Në disa raste, gjykatësit janë përballur me mungesë të dëshmitarëve për tu paraqitur me dëshmitë e tyre në shqyrtimet gjyqësore. Gjykatësit kanë ftuar seanca deri në pesë herë dhe nuk kanë arritur t'i sigurojnë dëshmitarët. Faji për këtë bie mbi prokurorët, të cilët nuk janë kujdesur që të bëjnë grumbullimin e saktë të të gjitha informatave rreth këtyre dëshmitarëve. Intervista e KIPRED-it me kryetarin e Gjykatës Supreme të Kosovës, z. Fejzullah Hasani, gusht 2011.

⁷⁸ Drejtësia në Kosovë. Shih <http://www.jetanekosove.com/drejtësia/645/Alb> (qasur për herë të fundit më 28 shtator 2010). 20 dhjetor 2010.

Mungesa e vullnetit dhe gatishmërisë së gjykatësve për të zgjidhur këto raste mund të rezultojë me ngulfatje të sistemit gjyqësor kur kemi parasysh se në proces të ngritjes së aktakuzave të drejtpërdrejta janë 174 raste me raporte preliminare, në të cilat mund të përfshihen 1,217 të akuzuar. Gjykata Supreme patjetër se duhet të veprojë për të menaxhuar më mirë këtë punë ngase së shpejti gjyqësori mund të përballet me rreth dhjetë herë më shumë raste të zgjedhjeve sesa që aktualisht ka në punë.⁷⁹ KIPRED konsideron se gjykatësit duhet të marrin seriozisht qarkoren e Gjykatës Supreme në mënyrë që t'i përgjigjen me efikasitet zgjidhjes së këtyre lëndëve me prioritet. Ndryshe, druhet se zvarritja në moszgjidhjen dhe mosndëshkimin e manipulimit të zgjedhjeve, sikurse është vepruar edhe në të kaluarën, do të ndikojë tejet negativisht për të gjitha proceset në vend. Nëse ndëshkimi i manipuluesve zvarritet si deri tash, manipuluesit nuk do të zbrapsen dhe këto krime të zgjedhjeve lehtë mund të përsëriten.

7.2. Dënimet e shqiptuara nga Gjykatat Komunale

Dënimet e shqiptuara nga gjykatat komunale për manipuluesit e zgjedhjeve në Kosovë janë të pakta, të pamjaftueshme dhe qesharake. Për më tepër ato nuk i përgjigjen thirrjeve të ligjit për të arritur efektet juridike, që përmes dënimeve të shqiptuara sadopak të rikuperohen dëmet e shkaktuara. Mbi 90% e dënimeve kanë qenë joadekuate, të cilat mund të interpretohen se gjykatësit kanë gjykuar se dëmet e krimeve të zgjedhjeve të kryera gjatë zgjedhjeve të përgjithshme në vitin 2010 kanë qenë kryekëput simbolike. Dënimet e tilla ngjajnë më shumë me gjoba të kundërvajtjes sesa dënime për vepra penale me pasoja të rënda.

⁷⁹ KIPRED ka kalkuluar të dhënat e QNR, të cilat mund të shërbejnë për prokuroritë komunale që të ngritin aktakuza të drejtpërdrejta, që do të përfshinin rreth 5,000 komisionerë të zgjedhjeve të akuzuar. Aktualisht gjykatat komunale kanë pas 78 raste të zgjedhjeve në punë, ndërsa me rastet e aktakuzave të drejtpërdrejta që mund të ngriten nga prokuroritë, pasi që ekzistojnë raportet preliminare me shkelje të vërtetuara nga QNR, ky numër do të shtohet për 712 raste tjera të reja, që i bie diku rreth 10 herë më shumë sesa aktualisht.

DËNIMET	Liruar	Gjobë	Dënim me kusht	Pa specifikuar	Veçuar procedura penale	Dënim me burg efektiv
Gjilan	1					1
Kamenicë			2			2
Viti						
Prizren	1					
Dragash						
Pejë						
Gjakovë		1				
Prishtinë			1	1		
Ferizaj	7		11			1
Shtërpçë	3		5			
Glllogovc	4	56	12		2	2
Kaçanik		3				
Lypjan		1				
Skenderaj		1				
Vushtrri						1
TOTAL:	16	62	31	1	2	7
% nga totali	13.4%	52.1%	26.1%	0.8%	1.7%	5.9%

Tabela 9 - Dënimet e shqiptuara për krimet e zgjedhjeve

Gjykatat Komunale nga 78 raste ku janë përfshirë 319 të akuzuar, kanë shqiptuar dënime ndaj 119 personave.⁸⁰ Në 92% të këtyre rasteve, dënimet janë me gjobë, kusht, apo janë liruar, ndërsa dënimi me burg efektiv është shqiptuar në raste të rralla,⁸¹ thuajse ky lloji i dënimit është në zhdukje dhe se zgjedhjet kanë qenë problemi më i vogël në vend. Nga të gjithë të dënuarit kemi 62 persona të dënuar me gjobë, 31 persona dënim me kusht, 16 persona të liruar, ndërsa vetëm shtatë persona janë dënuar me burg.

Dënimet me gjobë janë të vlerave të ndryshme duke filluar nga 250 Euro e deri te dënimi më i lartë që arrin në 1,350 Euro. Gjykata Komunale në Drenas me gjithsej 20 raste që kanë përfshirë 128 persona, ka numrin më të madh të rasteve deri më tash, ku ka zgjidhur 65% të

⁸⁰ Komunikimi i KIPRED-it me Departamentin e Statistikave në Sekretariatit e KGJK-së, gusht 2011.

⁸¹ Po aty.

rasteve dhe ka shqiptuar numrin më të madh të dënimeve me gjobë. Në këtë gjykatë, 56 persona janë dënuar me gjobë, pasi që me pëlqim të palëve është mundësuar që burgu të shndërrohet në dënim me gjobë.⁸² Deri më tani Gjykatat Komunale kanë shqiptuar dënime me kusht për 31 persona, të cilat mund të cilësohen vetëm si vërejtje ashtu që në të ardhmen të mos përfshihen në krime të tilla.

Këto dënime parashohin që vendimi i gjykatës nuk do të ekzekutohet derisa personi i dënuar të mos përfshihet në vepra kriminale deri në periudhën e caktuar, që në këto raste kemi vërejtur se periudha më e gjatë e shqiptuar është dy vite. Në këtë mënyrë jo që dënimet nuk kanë kryer efektin, por kanë mundësuar që personat e njëjtë të mund të jenë protagonist të vjedhjeve në zgjedhjet e ardhshme, duke pasur parasysh që dënimi me kusht do të përfundoj para se të mbahen zgjedhjet e ardhshme. Gjykatat Komunale kanë dënuar me burg efektiv vetëm shtatë nga 119 persona sa kanë qenë të përfshirë në lëndët e zgjedhjeve të cilat janë zgjidhur deri më tani. Dënimi më i madh i shqiptuar është një vit burg dhe gjithë të tjerat janë kryesisht dënime prej tre apo gjashtë muajsh. Me vetëm shtatë persona të dënuar me burg efektiv për një krim kaq të dëmshëm për shoqërinë dëshmohet se dënimet e gjykatave janë skandaloze dhe se gjykatësit kanë keqkuptuar efektin e dënimit.

Pavarësisht tendencës së sistemit gjyqësor dhe prokurorial që të jetë sa më i pavarur nga pushtetet tjera, duhet të merret parasysh se ligjet janë mbështetur nga shumica e përfaqësuesve të popullit që janë në Kuvendin e Kosovës dhe si të tilla duhet të zbatohen nga të gjithë. Me një praktikë të tillë të dënimeve, gjyqësori gjendet shumë larg vullnetit të shprehur nga legjislativi, i cili kishte aprovuar dispozita për ndëshkim të cilat shkojnë deri në disa vite burgim, madje edhe krijojnë hapësirë që këto raste të hetohen si raste të krimit të organizuar.

Neni 180 i Kodit Penal të Kosovës për veprën penale të mashtrimeve në zgjedhje parashikon dënime deri në pesë vite burgim efektiv. Në bazë të trendit të tanishëm të dënimeve vështirë që do të shohim ndonjëherë të shqiptohet një dënim i tillë. KIPRED duke qenë themelues i koalicionit të organizatave të shoqërisë civile “Demokracia në Veprim”, ka qenë i përfshirë drejtpërdrejtë në monitorimin e të gjitha zgjedhjeve të organizuara në Kosovë nga viti 2007. Parregullsitë e zgjedhjeve 2010 kanë qenë të paprecedent dhe pikërisht ngathtësia e organeve të drejtësisë për të vendosur prapa grilave personat të cilët kanë abuzuar me votat e qytetarëve ka stimuluar dhe ka intensifikuar personat e caktuar dhe grupe të organizuara të përfshihen në vjedhjen e votave dhe manipulimin e zgjedhjeve. Në një situatë ku nuk ka mbetur kush pa kritikuar vjedhjet enorme të votave dhe mashtrimet në zgjedhje, gjykatat marrin vendime të cilat aspak nuk i kontribuojnë ndërtimit të një shteti ku qytetarët do të kenë të drejtë të lirisë së votimit. Vendimet e gjykatave komunale jo që nuk janë as të përafërta me dënimet të cilat do të kryenin efektin e duhur sa i përket krimeve të zgjedhjeve por janë aq të lehta saqë mund të krahasohen me dënimet që shqiptohen për kundërvajtje trafiku.

⁸² Në përgjithësi, dënimet me një muaj burg janë shndërruar në gjobë prej 450 Euro, për dy muaj burgim është shndërruar në 900 Euro, dhe për tre muaj burgim është shndërruar në 1,350 Euro gjobë. Komunikimi i KIPRED-it me Departamentin e Statistikave në Sekretariatit e KGJK-së, gusht 2011.

Gjatë këtij hulumtimi instituti KIPRED nuk ka shikuar ndikimin politik në punën e prokurorive dhe gjykatave kur vjen puna te krimet e zgjedhjeve. Megjithatë, një studim i veçantë për pavarësinë e pushtetit gjyqësor i botuar në shtator 2011 ka gjetur se përkundër garantimit të ndarjes së pushteteve me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, ekzistojnë ligjet dhe praktika që krijojnë varësi të gjyqësorit ndaj ekzekutivit.⁸³ Analiza thekson fenomenin e nënshtrimit të gjykatësve ndaj figurave politike në rastet gjyqësore kur ata janë të përfshirë. Tutje, analiza nxjerr në pah fenomenin e vetë-cenzurimit të gjykatësve në trajtimin e këtyre rasteve, ku shpesh politikanët nuk kanë pasur nevojë që të ushtrojnë ndikim ndaj tyre.

Ani pse nuk është studiuar në veçanti, do të ishte e natyrshme që presioni politik të jetë edhe më i madh në rastet që kanë të bëjnë me zgjedhjet, meqë procesi zgjedhor rezulton drejtpërdrejt në vet qenësinë e partive politike. Por ajo që është hasur gjatë këtij hulumtimi është fakti që gjykatësit janë duke u vetë-cenzuruar dhe kjo paraqet një shembull negativ posaçërisht kur janë duke u zhvilluar hapa të mëdhenj në reformimin e sistemit gjyqësor.

Ndikimi i dënimeve të vogla ka një shtrirje shumë dimensionale duke dëmtuar më së shumti shoqërinë kosovare në tërësi. Qytetarët e Kosovës veç janë të dëshpëruar nga procesi zgjedhor në Kosovë pasi që ka skepticizëm nëse vota e tyre do të vlejë. Situata do të bëhet edhe më dëshpëruese kur personat të cilët kanë ndjell gjithë këtë pasiguri në mesin e qytetarëve nuk do të vuajnë asnjë ditë burg, përderisa mundësitë janë që ata të dënohen deri në pesë vite me burgim. Siç shpjegohet edhe në hyrje të kësaj analize, të gjitha hallkat tjera duke përfshirë edukimin e votuesve, trajnimin e komisionerëve, e angazhime tjera në këtë drejtim janë plotësisht të varura nga funksionimi i gjyqësorit në mënyrë efikase dhe të paanshme.

Dënimet e shqiptuara deri më tani nga gjyqësori mund të cilësohen sikur tarifa për blerje të votave. Në një mënyrë gjyqësori ka legalizuar tregtinë me votat, gjë që paraqet degradim të votës së qytetarit dhe dyfishon efektet negative të manipulimit të zgjedhjeve.

Drejtnesit e institucioneve të drejtësisë kanë ngritur menjëherë shqetësimet rreth dënimeve të cilat janë shqiptuar rreth këtyre rasteve. Në këtë frymë, gjykatësit si duket kanë keqkuptuar shpalljen si lëndë prioritare duke tentuar që të arrihet numër i lëndëve të përfunduar dhe jo të ketë fokus në cilësinë e vendimeve për këto lëndë. Madje, Prokurori i Shtetit ka marrë qëndrim të prerë se për të gjitha gjykimet e gjykatave do të paraqes ankesë ashtu që ato lëndë të shkojnë në gjykata të qarkut për një shqyrtim tjetër.

Me gjithë problemet e cilësuar në ndarjen e drejtësisë nëpër Gjykatat Komunale, ka ende shpresë se gabimet e bëra nga gjykatësit e shkallës së parë të përmirësohen në shkallët tjera të zinxhirit të gjykatave, përkatësisht Gjykatat e Qarkut. Duke parë zmbropsjen e gjykatësve komunal, mbetet në duart e gjykatësve të Gjykatave të Qarkut që të dëshmojnë pjekurinë dhe etikën e tyre profesionale për ndëshkimin meritore të abuzuesve të zgjedhjeve. Gjithashtu, Gjykatat e Qarkut obligohen të zgjidhin me prioritet këto lëndë sipas qarkores së Gjykatës Supreme.

⁸³ Gashi A., Musliu B.. "Pushteti i pandashëm: Analizë e pavarësisë së pushtetit gjyqësor në Kosovë." Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave. Shtator 2011.

8. NDJEKJA PENALE SI KRIM I ORGANIZUAR

Në zyrën e Prokurorit të Shtetit të Republikës së Kosovës ka një grumbull dosjesh për manipulimin e zgjedhjeve të organizuara në Kosovë që prej vitit 2007 deri më tash. Kryerja e krimeve të zgjedhjeve si një formë mjaft e përhapur patjetër se ka kërkuar bashkëpunim të ngushtë ndërmjet kryesve. Në bazë të provave të siguruar nga QNR, prokuroria kanë përgatitur raporte preliminare për të ngritur aktakuza të drejtpërdrejta për 174 raste të cilat përfshijnë 1,217 komisionerë.⁸⁴ Për dallim nga zgjedhjet e kaluara, në zgjedhjet e vitit 2010, PZAP dhe QNR kanë siguruar një bazë të mirë të provave për prokurorinë për ndjekjen e keqpërdorimeve në zgjedhje.

Dështimi i tri hallkave të sistemit të drejtësisë në trajtimin e duhur dhe meritot të rasteve të manipulimit të zgjedhjeve, padyshim se ka ndikuar tek manipuluesit, të cilët veç sa janë stimuluar për të rritur shkallën e manipulimeve. Andaj, një manipulim i një shkalle kaq të lartë kërkon hulumtim dhe analizim të mirëfilltë të çdo veprimtarie kriminale të zgjedhjeve. Duke pasur parasysh se të gjitha këto manipulime janë bërë nga komisionerët të cilët kanë qenë anëtarë dhe të deleguar të partive politike, përgjegjësia për manipulimet bie mbi ta dhe eprorët e tyre.⁸⁵ Duke pasur parasysh se një vjedhje e tillë e votave kërkon organizim dhe koordinim të më shumë se dy personave, hetimet mund të nxjerrin para drejtësisë ndonjë grup të strukturuar apo ndonjë ndërmarrje kriminale.⁸⁶

Prokurorët duhet të hetojnë ndonjë ndërlidhje të komisionerëve me persona tjerë të cilët kanë mundur të nxisin, shtyjnë, financojnë, apo ndihmojnë, ata në kryerjen e veprës penale.⁸⁷ Deri më tani, Prokuroritë Publike Komunale të Kosovës kanë akuzuar rreth 500 persona për manipulime masive të zgjedhjeve,⁸⁸ ndërsa në proces do të duhej të ishin edhe rreth 4,500 komisionerë, ndaj të cilëve ka bazë të mjaftueshme të ngritën aktakuza të drejtpërdrejta.⁸⁹ Numri kaq i madh i personave të përfshirë në manipulim të zgjedhjeve paraqet dyshim të mjaftueshëm për të filluar hetime të këtij lloji. Pjesa dërmuese e tyre ndiqen për veprën penale “mashtrimi në votime,”⁹⁰ për të cilën vepër parashihet dënimi me burgim prej gjashtë

⁸⁴ Raporti gjashtëmujor, (janar-qershor 2011), lidhur me lëndët që kanë të bëjnë me zgjedhjet e parakohshme parlamentare të mbajtura më 12 dhjetor.

⁸⁵ Sipas znj. Valdete Daka, Kryetare e KQZ-së, “Për manipulimet që kanë ndodh në ditën e zgjedhjeve këtë e bartin plotësisht 100% partitë politike sepse ata kanë qenë ideator, ata kanë qenë zbatues, dhe ata janë kanë implementues të atyre manipulimeve.” Intervistë e KIPRED-it me Kryetaren e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, znj. Valdete Daka. Tetor 2011.

⁸⁶ Intervistat e KIPRED-it me ekspertët juridik, korrik 2011.

⁸⁷ Deklaratë e ekspertit Dastid Pallaska, në emisionin “Drejtësia në Kosovë”: “Prokurori i mirë i shqyrton të gjitha mundësitë e mundshme, definitivisht se një komisioner me një fshat të thellë të Kosovës nuk ka kush e di se çfarë interesi me manipulim të zgjedhjet dhe definitivisht se prapa tij apo prapa gjithë atyre personave që kanë kry këto vepra penale kanë ekzistuar persona që i kanë nxitur, që i kanë shtyrë, financiar, dhe i kanë ndihmuar para, gjatë dhe pas kryerjes së veprës penale. Të gjitha këto përbëjnë elemente të cilat duhet të shqyrtohen dhe assesit të paragjykohej se a ka ekzistuar apo jo por duhet të shqyrtohen, të cilat mund të qojnë deri të konkludimi se ndoshta ka pasur ndonjë ndërmarrje të përbashkët kriminale për kryerjen e këtyre veprave penale,” “Drejtësia në Kosovë,” dhjetor 2010.

⁸⁸ Raporti gjashtëmujor, (janar-qershor 2011), lidhur me lëndët që kanë të bëjnë me zgjedhjet e parakohshme parlamentare të mbajtura më 12 dhjetor.

⁸⁹ Komunikim i KIPRED-it përmes telefonit dhe postës elektronike me Koordinatorin e Qendrës së Numërimit dhe Rezultateve, z. Burim Ahmetaj, korrik 2011.

⁹⁰ Raporti gjashtëmujor, (janar-qershor 2011), lidhur me lëndët që kanë të bëjnë me zgjedhjet e parakohshme parlamentare të mbajtura më 12 dhjetor.

muajve deri në pesë vjet.⁹¹ Mashtrimi nga komisionerët, në secilin vendvotim është bërë në bashkëpunim të ngushtë ndërmjet tyre si grup i strukturuar,⁹² në të kundërtën assesi nuk do të mund të kryeshin manipulimet kaq masive në zgjedhje.

8.1. Dështimi i materialeve zgjedhore

Mbarëvajtja e procesit zgjedhor është rregulluar nga KQZ përmes Rregullores së Brendshme,⁹³ gjë që na mundëson të analizojmë veprimet dhe përgjegjësitë individuale dhe të përbashkëta që kanë pasur komisionerët e KQZ-së para, gjatë dhe pas procesit zgjedhor.

Në zgjedhjet 2010, komisionerët kanë lejuar fillimin e procesit të votimit pa qenë materialet në rregull.⁹⁴ Një gjë e tillë nuk është dashur të ndodh dhe se rregullat e brendshme të KQZ-së përshkruajnë deri në detaje të gjitha përgjegjësitë dhe procedurat. Bazuar në rregullat e brendshme të KQZ-së, procedurat para se të fillojë votimi në ditën e zgjedhjeve në orën 06:00, detyrojnë dhe bëjnë përgjegjës Kryesuesin e KVV-së dhe zëvendësin e tij që t'i kontrollojë të gjitha materialet nga Komisioni Komunal Zgjedhor (KKZ), duke përfshirë këtu ato më kryesoret si: fletëvotimet me kusht, fletëvotimet, kutitë e votimit, kabinat e votimit, llambën ultravjollce, ngjyrën e padukshme, vulën zyrtare të fletëvotimit, ngjyrën, mbushësit e ngjyrës, librin e votimit, dhe materialin për zyrë.⁹⁵ Nëpër vendvotime të ndryshme nuk kanë funksionuar llambat dhe ngjyra e padukshme.⁹⁶ Pasi ka filluar procesi i votimit, ky problem ka filluar të shfaqet si fenomen në tërë Kosovën, për çka janë alarmuar të gjithë faktorët, përfshi edhe përgjegjësit - KQZ-në.⁹⁷ Për llamba dhe bateri KQZ ka shpenzuar 5,265 Euro, ndërsa për ngjyrë të padukshme ka shpenzuar 28,800 Euro.⁹⁸ Zyrtarët e Prokurimit në Sekretariatën dhe strukturat e tjera, përfshi ato udhëheqëse, të KQZ-së janë përgjegjësit kryesor për dështimin e këtyre produkteve qenësore për të mundësuar mbarëvajtjen e procesit zgjedhor.

Procesi zgjedhor assesi nuk është dashur të fillojë pa u evidentuar dhe evituar këto probleme. Ky problem ka mundur të trajtohej si rast i izoluar nëse si i tillë do të ndodhte në një numër të

⁹¹ Në mënyrë që një vepër të mund të ndiqet si vepër penale Krim i Organizuar, ajo vepër duhet të jetë e dënueshme së paku me pesë (5) vite burgim. Neni 274 – Krimi i Organizuar, alinea 2. Kodi Penal i Kosovës.

⁹² Neni 274, Krimi i organizuar, “Shprehja “grup i strukturuar” do të thotë grup prej tre ose më shumë personave i cili nuk është formuar rastësisht për kryerjen e atypëratyshme të ndonjë vepre penale dhe nuk do të thotë formalisht t'i ketë të përkufizuara rolet për anëtarët e tij, vazhdimësinë e anëtarësisë së tij apo strukturën e zhvilluar”. Kodi Penal i Kosovës.

⁹³ Votimi dhe Numërimi brenda Vendvotimeve në nivelin e Komisionit Komunal Zgjedhor; Rregullën Zgjedhore Nr. 09/2009. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

⁹⁴ Sipas Demokracisë në Veprim, në shumë vendvotime nuk kanë funksionuar llambat ultravjollce si dhe ngjyra e padukshme. Komunikatë për media. Demokracia në Veprim. Shih http://www.demokracianeveprim.org/al/printo.php?subaction=showfull&id=1292337622&archive=&start_from=&ucat=& (qasur për herë të fundit më 26 shtator 2011).

⁹⁵ Neni 7, “Procedurat Para se të Fillojë Votimi”, Votimi dhe Numërimi brenda Vendvotimeve në nivelin e Komisionit Komunal Zgjedhor; Rregullën Zgjedhore Nr. 09/2009. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

⁹⁶ Sipas Demokracisë në Veprim, në shumë vendvotime nuk kanë funksionuar llambat ultravjollce si dhe ngjyra e padukshme. Komunikatë për media. Demokracia në Veprim. Shih http://www.demokracianeveprim.org/al/printo.php?subaction=showfull&id=1292337622&archive=&start_from=&ucat=& (qasur për herë të fundit më 26 shtator 2011).

⁹⁷ Po aty.

⁹⁸ Raporti i Shpenzimeve për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës 2010, Raporti i KQZ-së. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

vogël të vendvotimeve. Por, kur një gjë e tillë ndodh në një pjesë të madhe të vendvotimeve, atëherë duhet të hetohet edhe përtej qendrave të vendvotimit, dhe të gjendet emëruesi i përbashkët i këtij dështimi. Përgjegjësia do duhej të fillonte prej secilit kryesues dhe zëvendëskryesues që kanë lejuar fillimin e procesit zgjedhor pa plotësimin e kushteve të nevojshme për mbarëvajtje të votimit. Përgjegjësia shkon në hierarki tek të gjithë mbikëqyrësit e tjerë dhe përfundimisht drejtuesit e Sekretariatit të KQZ-së, si përgjegjës kryesor për sigurimin e kushteve të parapara me ligj për mbarëvajtje të procesit zgjedhor. Andaj, mbetet shqetësues fakti se si prokurorët e ngarkuar me hetimin e shkeljeve dhe manipulimeve që janë bërë në zgjedhje nuk i kanë zgjeruar hetimet për këtë grup.

Mungesa e një kontrolli efikas si rrjedhojë e problemeve teknike organizative ka krijuar hapësirën e mjaftueshme për krime të zgjedhjeve, gjë edhe që është shfrytëzuar nga komisionerët dhe militantët partiak.⁹⁹ Rrjedhimisht, keqpërdoruesit kanë mundur të votojnë disa herë dhe raste kur të njëjtit persona kanë votuar disa herë janë evidentuar gjatë ditës së zgjedhjeve.¹⁰⁰ Andaj, çdo kush që ka votuar dy herë në një proces zgjedhor ka bërë shkelje të ligjit, gjë që dënohet penalisht.¹⁰¹ Qysh në këtë fazë fillestare të procesit zgjedhor ka ekzistuar një bashkëpunim ndërmjet komisionerëve dhe eprorëve të tyre, duke lejuar kryerjen e veprave penale pasi kanë mundësuar keqpërdorimin e procesit të votimit. Natyrisht, ky bashkëpunim për kryerjen e këtyre veprave të rënda penale nuk ka mundur të kryhet në shumicën e vendvotimeve dhe qendrave zgjedhore në Kosovë, pa pasur një organizim, një strukturë organizative dhe një shtytje të këtyre komisionerëve. Këtë orientim të hetimeve do duhej ta kishin parasysh prokurorët, duke analizuar masën e përfshirë në manipulime dhe mënyrën sesi ata i kanë kryer këto krime të zgjedhjeve.

8.2.Manipulimi i numërimit të votave

Secila KVV është përbërë nga shtatë (7) komisionerë të cilët kishin përgjegjësi të ndara në mes vete dhe ishin përgjegjës për mbarëvajtjen e procesit zgjedhor në vendvotimet e caktuara. Dështimet e mundshme do ishte shumë e lehtë që të evitoheshin pasi që të shtatë komisionerët ishin prezent nga fillimi deri në përfundim të procesit. Madje, në fund secili nga komisionerët ka qenë i detyruar të vendos nënshkrimin në formularët të cilët kanë përmbajtur të gjitha të dhënat rreth mbarëvajtjes së procesit dhe votave e fletëvotimeve sa i përket vendvotimit të caktuar.

Qëllimi i procedurave për numërimin e fletëvotimeve të rregullta do duhej të udhëhiqej me saktësi, transparencë, efikasitet dhe mbrojtje të sigurisë së votës.¹⁰² Stafit përgjegjës për organizim dhe mbarëvajtje të zgjedhjeve kishte dështuar që të sigurojë një proces i cili i

⁹⁹ Deri më tani Prokuroritë Publike Komunale kanë ngritur aktakuza ndaj rreth 500 personave. Raporti gjashtëmuor, (janar-qershor 2011), lidhur me lëndët që kanë të bëjnë me zgjedhjet e parakohshme parlamentare të mbajtura më 12 dhjetor.

¹⁰⁰ Zgjedhjet Parlamentare në Kosovë 2010 – Raporti Final. Misioni për Vëzhgimin e Zgjedhjeve. Rrjeti Evropian i Organizatave për Monitorimin e Zgjedhjeve (ENEMO), prill 2011.

¹⁰¹ Neni 11, Votimi i Rregullt, alinea 11.12 “Votimi në të njëjtën zgjedhje më shumë se një here paraqet vepër penale dhe është e dënueshme në pajtim me Kodin Penal të Kosovës”, Rregullën Zgjedhore Nr. 09/2009.

¹⁰² Neni 15, Procesi i Numërimit në Vendvotimet e Rregullta, alinea 15.1 “Procedurat e numërimit të fletëvotimeve të rregullta do të udhëhiqen nga qëllimet e paraqitura: saktësia, transparenca, efikasiteti dhe mbrojtja e sigurisë së votës. Rregullën Zgjedhore Nr. 09/2009. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

përgjigjet këtyre qëllimeve. Pas identifikimit të një numri të madh të parregullsive në formularët e rezultateve të kandidatëve, QNR kishte filluar rinumërimin e 40% të votave, ku formularët për 712 vendvotime kanë rezultuar të përmbajnë parregullsi të cilat janë të natyrës së manipulimit me votat e kandidatëve.¹⁰³ Këto parregullsi janë rezultat i komisionerëve përgjegjës që kanë përbërë Ekipet e Numërimit nëpër vendvotime. Këto ekipe në prani të Kryesuesit, në mënyrë të solidarizuar kanë keqpërdorur mundësinë që të manipulojnë votat e kandidatëve. Procedurat e KQZ-së në mënyrë të saktë sqarojnë të gjitha procedurat për fazën e numërimit dhe manipulimet në formularë mund të kryhen vetëm me një bashkëpunim të ngushtë ndërmjet komisionerëve dhe vetë kryesuesit të KVV-së. Ky i fundit është përgjegjësi kryesor për përpilimin dhe saktësinë e rezultateve të numëruara.¹⁰⁴ Bazuar në manipulimet masive që kanë ndodhur, rezultojnë se Kryesuesit kanë udhëhequr dhe miratuar çdo keqpërdorim të ndërmarrjes së përbashkët kriminale gjatë procesit zgjedhor.

8.3. Baza ligjore për ndjekjen e krimeve të zgjedhjeve si krim i organizuar

Baza ligjore për ndjekjen e këtyre manipulimeve masive të zgjedhjeve ekziston. Prokurorët Komunal deri tash pjesën dërmuese i ka akuzuar për veprën penale të mashtrimit në votime, për të cilën dënimi parashihet prej gjashtë muajve deri në pesë vjet burgim. Për tu plotësuar kushtet ligjore për ndjekjen penale të veprës penale krimi i organizuar, duhet që vepra penale të jetë e dënueshme me pesë vjet burgim. Ky kriter ligjor përmbushet për shumicën e të akuzuarve deri më tash nga prokurorët, pasi të gjithë gati akuzohen për veprën penale të mashtrimit në votime. Kodi Penal i Kosovës ka specifikuar qartë domethënien e grupit kriminal të organizuar, që nënkupton grup të strukturuar, i cili ekziston për një kohë të caktuar dhe vepron bashkë me qëllim të kryerjes së krimeve të rënda për përfitim të drejtpërdrejtë ose tërthortë të dobisë pasurore apo financiare.

Duke pasur parasysh resurset të cilat janë nën kontrollin e politikës në Kosovë, interesat e komisionerëve për të kryer këto krime mund të jenë të ndërlidhura drejtpërdrejtë apo tërthorazi me dobi pasurore apo financiare. Shpeshherë partitë politike janë akuzuar për punësim të militantëve në Administratën Shtetërore si dhe nëpër Ndërmarrjet Publike.¹⁰⁵ Tutje, procesi i prokurimit publik shpeshherë është kritikuar si një proces që ka mjaftë ndikime politike dhe nuk krijon hapësirë për konkurrencë korrekte dhe të drejtë.¹⁰⁶

¹⁰³ “Zgjedhje të reja në Kosovë.” Telegrafi. Shih <http://www.telegrafi.com/?id=26&a=3207> (qasur për herë të fundit më 4 tetor 2011).

¹⁰⁴ Neni 15, Procesi i Numërimit qasur më 9 Kryesuesi i KVV-së do të jetë përgjegjës për përpilimin dhe saktësinë e rezultateve të numëruara, të shënuara në formularin përkatës të Rezultateve. Rregullën Zgjedhore Nr. 09/2009. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

¹⁰⁵ Deklarata e Ministrit të Administratës Publike, z. Mahir Jaghillar, “Politizimi është bërë me kohë, por janë reformat në administratën publike të cilat po i bëjmë dhe në të ardhmen do të zvogëlohet politizimi.” Llapashtic J. “Politizimi rrit frustrimin”. Zëri Info. Shih <http://www.zeri.info/artikulli/2/8/35697/politizimi-rrit-frustrimin/> (qasur për herë të fundit më 6 tetor 2011). Po ashtu, deklarata e ish-Ministres së Administratës Publike, znj. Edita Tahiri, se politizimi i administratës publike është bërë në vazhdimësi gjatë 10 viteve të fundit nga ata që kanë udhëhequr vendin. “Përpjekje për depolitizimin e administratës”. Express. Shih <http://gazetaexpress.com/index.php?cid=1,15,41834> (qasur për herë të fundit më 6 tetor 2011).

¹⁰⁶ Raporti i Progresit për vitin 2010 për Kosovën ngrit shqetësime rreth nivelit të korrupsionit në vend që ndërlidhet me fushën e prokurimit publik. Raporti i Progresit 2010 për Kosovën. Komisioni Evropian.

Zbulimin e organizatorëve, shtytësve, kryesve dhe atyre që janë solidarizuar me këto krime masive zgjedhore do të mund ta ndihmonin shumë vetë partitë politike, përgjegjëse për mbarëvajtjen e procesit zgjedhor. Mirëpo, meqë individë të shumtë brenda tyre vetë janë përfshirë në këto krime, kjo ka ndikuar që përveç deklarimeve mediale, kontributi i tyre të jetë minimal për ndriçimin e këtyre rasteve të manipulimeve. Megjithatë, kjo mbetet në kompetencën e prokurorëve, të cilët duhet të bëjnë hulumtime të thella për krimet e zgjedhjeve, dhe të shkojnë përtej krimeve individuale për të identifikuar ndërmarrjet e përbashkëta kriminale që kanë vepruar. Gjykatësit, poashtu, mund të kontribuojnë në zbardhjen e këtyre ndërmarrjeve kriminale duke deleguar lëndët në kompetencë të Gjykatave të Qarkut në rastet kur vërehet se bashkëpunimi dhe interesi për manipulim ka qenë më i lartë sesa ai individual.

Ndjekja penale dhe gjykimi për vepra penale të krimit të organizuar është thelbi për të çrrënjosur manipulimet masive në të ardhmen.

9. GJETJET E PËRGJITHSHME

Manipulimi i procesit zgjedhor assesi nuk ndërlidhet me sistemin zgjedhor, por është kryekëput kontribut i grupeve të organizuara me ndikime politike, në kombinim me dështimin e organeve të drejtësisë për të ndjekur dhe dënuar këto raste si dhe paaftësisë së KQZ-së për të parandaluar këto manipulime. Manipulimi i votave të qytetarëve ka shkaktuar dëme në disa sfera të shoqërisë dhe qeverisjes në Kosovë. Vjedhja masive e votave dëmton shumë rëndë procesin e llogaridhënies të anëtarëve të legjislativit ndaj qytetarëve që është një nga vlerat bazike për konsolidimin e demokracisë në vend. Për më tepër, vjedhja e votave ka rezultuar me pasoja të rënda në disa aspekte tjera sikurse që është humbja e kohës së qytetarëve për të dalë në rivotim, humbja e besimit të qytetarëve në procesin zgjedhor, kosto financiare përfshirë atë për riorganizimin e zgjedhjeve, si dhe pasoja tjera sikurse që është kriza institucionale. Tutje, vjedhja e votave kishte dëmtuar aq rëndë imazhin e Kosovës në arenën ndërkombëtare sa që mediat më të mëdha botërore kishin raportuar për keqpërdorimet e shumta.

Sekretariati i KQZ-së ishte detyruar që të organizonte rivotim dhe të rinumëronte votat gjë që ka rezultuar me shpenzime prej mbi 674 mijë Euro. Përkundër asaj se aktivistë të shoqërisë civile, partive politike, qytetarët, dhe persona tjerë kishin ngritur shqetësimin për vjedhjen dhe manipulimin e votave gjatë zgjedhjeve parlamentare, angazhimi i këtyre akterëve ishte kufizuar me deklaramë mediale dhe pothuajse ka përfunduar me përfundimin e procesit zgjedhor dhe zgjedhjen e qeverisë.

Organet e drejtësisë kishin injoruar në vazhdimësi rastet e zgjedhjeve të mbajtura në vitet 2007 dhe 2009 dhe të njëjtën gjë e kanë vazhduar në zgjedhjet e fundit të vitit 2010. Me vite të tëra organet e drejtësisë nuk kishin zhvilluar asnjë proces gjyqësor për këto raste. Deri më tani të tri hallkat e sistemit të drejtësisë kanë dështuar në ndjekjen dhe gjykimin e lëndëve të zgjedhjeve duke shpallur një numër simbolik të aktgjykimeve. Rrjedhimisht, manipuluesit e zgjedhjeve kanë shtuar apetitet e tyre dhe shkalla e manipulimeve është rritur gradualisht.

Vetëm pas zgjedhjeve të vitit 2010, organet e drejtësisë kanë vendosur që këto lëndë të trajtohen me prioritet. Fatkeqësisht, as qarkorja e nxjerrë për trajtimin e këtyre rasteve me prioritet nuk është zbatuar, duke lënë pa zgjidhur më shumë se gjysmën e këtyre lëndëve, rrjedhimisht duke amnistuar së paku në kohë manipuluesit e shumtë të zgjedhjeve. Në anën tjetër, korniza ligjore është e kompletuar dhe lejon dënimin e çdo lloj krimi që ndërlidhet me zgjedhjet. Legjislativi ka shprehur vullnetin që veprat e tilla të dënohen deri me 5 vjet burg dhe poashtu kanë krijuar hapësirë që veprat e tilla të hetohen edhe për krim të organizuar.

Përpjekjet dhe kontributi i subjekteve politike dhe akterëve tjerë përfshi shoqërinë civile për të zbardhur krimet e zgjedhjeve përmes rrugës ligjore ka qenë minimal. Pretendimet dhe pohimet verbale të disa subjekteve politike për manipulimet masive në zgjedhje në asnjë mënyrë nuk janë provuar përmes rrugës ligjore dhe institucionale. Partitë politike janë fokusuar tej mase në retorikën politike në media duke neglizhuar mekanizmat ligjor për të intervenuar në zbardhjen e rasteve të manipulimit. Përmes këtyre të fundit, liderët e disa partive madje kanë kërkuar me ngulm anulimin e tërë procesit zgjedhor, duke pretenduar se i tërë procesi është manipuluar.

Përkundër këtij kontributi minimal, lëvizja Vetëvendosje ka prirë në numrin e ankesave të dorëzuara në PZAP, e përcjell nga partitë politike tjera si PDK, AKR, FER, LDK, dhe AAK. Shembull i suksesit mund të përmendet rasti i komunës së Mitrovicës, ku me insistimin e lëvizjes Vetëvendosje çështja ishte ngritur në Gjykatën Supreme, gjë që ka rezultuar me anulim të zgjedhjeve në këtë komunë. Në anën tjetër, përkundër numrit të vogël të vëzhguesve, Rrjetit Ballkanik të Gazetarisë Hulumtuese (BIRN), kishte ngritur gjithsejtë 39 ankesa që ishin materializuar me vendime për anulim të zgjedhjeve nga PZAP. Ndërsa, koalicioni i OJQ-ve “Demokracia në Veprim”, e udhëhequr nga KDI, përkundër 5,000 vëzhguesve zyrtarisht nuk kishte arritur të paraqes asnjë ankesë. Akuzat e vazhdueshme verbale të pa materializuara përmes ankesave për parregullsi nëpërmjet rrugës ligjore në PZAP, dëshmojnë për një retorikë boshe, një papërgjegjësi dhe papjekuri të subjekteve politike e gjithashtu edhe të organizatave të shoqërisë civile drejt ndërtimit të shtetit ligjor.

Zbulimi i vjedhjeve dhe manipulimeve masive në zgjedhjet e vitit 2010 dhe procesit të rivotimit në vitin 2011, është bërë gjatë procesit të auditimit të formularëve. Përveç vjedhjes ordinere të votave ndërmjet partive, vjedhje që konsiderohet si risi dhe që ka shënuar rritje të paparë në këto zgjedhje ishin vjedhja e votave të kandidatëve brenda subjekteve politike, brengë kjo e ngritur edhe nga ish Presidenti në detyrë, njëkohësisht Sekretari i Përgjithshëm i partisë më të madhe në vend PDK, z. Jakup Krasniqi.

Vjedhja dhe manipulimi masiv kanë shtyrë nevojën që të rinumërohen 40% e votave nga QNR. Procesi i rinumërimit të votave të kandidatëve nga ana e QNR-së tregon se në përgjithësi në 890 vendvotime kishte probleme të natyrës së manipulimit dhe gabimeve matematikore. Në 80% të rasteve apo 712 vendvotime, procesi i rinumërimit ka nxjerrë në shesh parregullsi që ndërliidhen me vjedhjen dhe shtimin e votave të kandidatëve, ndërsa pjesa tjetër ndërliidhen me gabime më shumë të natyrës matematikore.

Këto të dhëna nxjerrin në shesh një amnisti, të cilën është duka ua bërë Prokurori i Shtetit manipuluesve dhe vjedhësve të votave. Deri më tash Prokurori i Shtetit ka akuzuar rreth 500 persona, ndërsa bazuar në këto të dhëna të QNR-së, 4,984 komisionarë të cilët kanë qenë të angazhuar në 712 vendvotime do të duhej të vendoseshin para drejtësisë. Në të gjitha këto raste ekzistojnë prova të bazuara të cilat do të shërbenin për organet e ndjekjes që të ngritën akuza të drejtpërdrejta, siç edhe është vepruar në një numër rastesh deri tash.

Gjykatat dhe prokuroritë nuk po arrijnë kurrësi që të krijojnë ndonjë platformë për të përcjellur progresin e zgjidhjes së lëndëve. Në këtë ndikon direkt mungesa e koordinimit dhe një baze të të dhënave në mes të institucioneve të drejtësisë sikurse që janë Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Gjykata Supreme, dhe Prokurori i Shtetit. Andaj, ekziston një paqartësi rreth progresit në zgjidhjen e këtyre lëndëve pasi që secili prej këtyre institucioneve posedon statistika që bien në kundërshtim njëra me tjetrën.

Zgjidhja e këtyre lëndëve nuk është bërë në përputhje me qarkoren e nxjerrur nga Gjykata Supreme e Kosovës, e cila i obligon gjykatat komunale që ato t'i trajtojnë si prioritet mbi prioritetet. Gjykatat deri më tani nuk kanë arritur të zgjidhin as gjysmën e lëndëve të cilat i kanë pranuar në punë. Me progresin jo të kënaqshëm, organet e drejtësisë paraqesin vetëm një element shtesë në hallkën e atyre të cilët përdorin retorikën politike por ju mungojnë veprimet konkrete në zbatim. Barra më e madhe për dështim të jashtëzakonshëm në shqiptim

të dënimeve bie mbi gjykatësit komunal, të cilët kanë gjykuar këto krime të zgjedhjeve me dënime me gjoba që nuk përkon me dëmet e shkaktuara.

Krimet e zgjedhjeve zgjedhore të pandëshkuara në zgjedhjet 2007 dhe 2009 stimuluan persona tjerë që të përfshiheshin në manipulim të votave gjatë zgjedhjeve të vitit 2010, ku edhe u arrit kulmi i keqpërdorimeve. Organi i akuzës duke injoruar këto raste ka lënë hetimin e tyre vetëm në nivelin komunal, pavarësisht faktit se kanë ekzistuar elemente të mjaftueshme për të trokitur në dyert e personave kryesor që kanë organizuar dhe shtyrë kryerjen e këtyre krimeve zgjedhore.

Kryerja e veprimtarive kriminale zgjedhore, sidomos kur kemi të bëjmë me një nivel kaq të lartë të keqpërdorimit, kërkon bashkëpunim të disa personave ku përfshihen edhe përfitime të caktuara. Andaj, për të gjitha veprat penale dhe dëmet e shkaktuara në zgjedhje nuk kemi vetëm përgjegjësi individuale, por përgjegjësi të një ndërmarrje të përbashkët kriminale.

Numri enorm i vjedhjes dhe manipulimit të votave, që deri më tash është finalizuar me ngritjen e aktakuzave ndaj rreth 500 komisionerëve, ku ky numër pritet të rritet në rreth 5,000 sosh, dëshmon për një masë e cila nuk ka mundur të veprojë në suaza individuale. Për të arritur këtë qëllim ka ekzistuar një organizim, një shtytje, një financim dhe ndihmë para, gjatë dhe pas kryerjes së krimeve të zgjedhjeve.

Baza ligjore ekziston dhe mundëson ndjekjen e këtyre krimeve të zgjedhjeve në kategorinë e krimit të organizuar, vepër penale kjo, të cilën prokurorët për fat të keq, nuk kanë proklamuar asnjëherë në diskursin e tyre. Vepra penale “mashtrimi në votime”, dënohet me burgim deri në pesë vjet. Shumica e të akuzuarve tash për tash ndiqen pikërisht për mashtrim në votime, pra duke mundësuar ndjekjen penale të tyre në kategorinë e krimit të organizuar. Në çdo vendvotim kanë qenë nga shtatë komisionerë të cilët patjetër se është dashur të bashkëpunojnë, apo të paktën të jenë pjesëmarrës pasiv në manipulimin me fletëvotime. Kjo dëshmon për një lidhje dhe strukturë të organizuar kriminale që ka vepruar në mënyrë të njëjtë në pjesën më të madhe të Kosovës.

Partitë politike, vëzhguesit, organet e drejtësisë dhe të gjithë mekanizmat tjerë të përfshirë në procesin e zgjedhjeve duhet dëshmuar të gjitha parregullsitë dhe dëmet e shkaktuara nga keqpërdorimet e zgjedhjeve të vitit 2010 dhe rivotimit në vitin 2011 duke ndjekur rrugët ligjore. Prokurorët komunal duke parë shkallën e lartë të keqpërdorimeve nuk duhet të hezitojnë në ndjekjen e tyre, por duhet të bashkëpunojnë me Prokurorinë Speciale të Kosovës, që të shqyrtohen të gjitha provat për ndjekjen e këtyre krimeve në kategorinë e krimit të organizuar. Vetëm përmes dënimit të organizatorëve të manipulimeve, do të arrihet që të shuhen ambiciet për keqpërdorime të një shkalle kaq të lartë. Gjykatësit do duhej të shqiptonin dënime të cilat i afrohen maksimumit të dënimit dhe jo të amnistojnë kriminelët e zgjedhjeve, marrë parasysh dëmet e mëdha që kanë shkaktuar.

10. REKOMANDIMET

Pas analizimit të gjetjeve të këtij studimi dhe konsultimeve me të gjithë akterët e përfshirë në organizimin e zgjedhjeve, por edhe institucionet e sundimit të ligjit dhe ekspertë të pavarur, KIPRED nxjerrë këto rekomandime për institucionet e Kosovës:

- 1) **Prokurori i Shtetit** duhet të zgjeroj hetimet dhe të orientojë ato edhe në drejtim të hetimit të veprës penale krimi i organizuar. Keqpërdorimet e shumta të paraqitura në PZAP dhe manipulimi në formularët e 712 vendvotimeve të identifikuar nga QNR, tregojnë për një përfshirje të një strukture të organizuar në manipulime. Për më tepër, koordinimi dhe bashkëveprimi i këtyre manipuluesve është bërë me qëllime përfitimi qoftë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë. Përfundimisht, Kodi Penal ka dhënë mundësinë që këto krime të ndiqen edhe si krim i organizuar. Andaj, Prokurori i Shtetit duhet të urdhërojë hetime të detajuara në rastet e zgjedhjeve, ku kontributin kryesor do të ketë Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK), në mënyrë që të zbulojë strukturën dhe organizimin e krimeve të zgjedhjeve.
- 2) Të gjitha keqpërdorimet e identifikuar nga QNR, që përfshijnë rreth 712 vendvotime apo afër 5,000 komisionerë, ku janë vërtetuar manipulimet me votat e kandidatëve duhet të shërbejnë që prokurorët të ngritin aktakuza të drejtpërdrejta. **Prokurori i Shtetit** duhet të urdhërojë hetimin e bashkëpunimit kriminal të komisionerëve në këto raste.
- 3) **Prokurori i Shtetit** duhet të urdhërojë hetime për dështimet e llambave dhe ngjyrës së padukshme. Këto dështime kanë mundësuar manipulimet në zgjedhje si dhe kanë qenë shkaktarë për organizim të rivotimeve. Andaj, ky dështim i kushtueshëm duhet hetuar nëse është bërë në mënyrë të qëllimshme për t'u ndjekur penalisht.
- 4) **Gjykatat Komunale** bazuar në dëmet e mëdha që kanë shkaktuar krimet e zgjedhjeve duhet të shqiptojnë dënime më të ashpra të cilat do të jenë adekuatë për të arritur qëllimin. Deri më tani, në 92% të rasteve, dënimet janë me gjobë, me kusht, apo të dënuarit janë liruar, ndërsa dënimi me burg efektiv është shqiptuar në raste të rralla. Në qoftë se vazhdohet me këtë trend të dënimeve, do të ndodh sikurse në të kaluarën ku manipuluesit vetëm sa do të stimulohen që të përfshihen në këtë veprimtari kriminale.
- 5) **Gjykata Supreme e Kosovës** duhet të ashpërsoj politikën e dënimeve në rastet e manipulimit të zgjedhjeve në Kosovë. Bazuar në dëmet e mëdha që kanë shkaktuar krimet e zgjedhjeve, gjykatësit duhet të ashpërsojnë dënimet e tyre në mënyrë që ato të arrijnë efektet juridike dhe rrjedhimisht të materializohet qëllimi i dënimit për kryerjen e veprave penale.
- 6) **Prokurori i Shtetit, Gjykata Supreme dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës** duhet të harmonizojnë veprimet e tyre në drejtim të zgjidhjes me prioritet të rasteve të zgjedhjeve. Këto raste duhet të monitorohen në vazhdimësi nga krerët e prokurorive dhe gjykatave, dhe të përpilohen raporte të rregullta për progresin e zgjidhjes së këtyre lëndëve. Përkundër nxjerrjes së qarkores për të zgjidhur me prioritet lëndët e

zgjedhjeve, gjykatat komunale ende nuk kanë arritur të vendosin as gjysmën e lëndëve.

- 7) **Policia e Kosovës** duhet të përfshihet më shumë në hetimin e rasteve të veprave penale që kanë të bëjnë me zgjedhjet. Kontributi i tyre duhet të jetë më i madh dhe sa më profesional në sigurimin e provave dhe dëshmive për zbulimin e strukturave të organizuara që veprojnë në kryerjen e veprave penale të zgjedhjeve.
- 8) **KQZ** duhet të ngritë kapacitetet mbikëqyrëse në përzgjedhjen dhe ofrimin e materialeve cilësore, të cilat mundësojnë mbarëvajtjen e një procesi të rregullt zgjedhor. Gjatë zgjedhjeve parlamentare të vitit 2010, kishin munguar specifikat për materialet zgjedhore, gjë që kompromenton cilësinë e këtyre materialeve.
- 9) **Vëzhguesit e zgjedhjeve**, përfshirë këtu partitë politike, përfaqësuesit e shoqërisë civile si dhe vëzhguesit tjerë duhet të kanalizojnë ankesat e tyre nëpër mekanizmat ligjor për hetimin dhe gjykimin e rasteve të manipulimit të zgjedhjeve. Në gjithë procesin zgjedhor ishin angazhuar mbi 32,000 vëzhgues të cilët gjithë së bashku kishin dorëzuar vetëm 454 ankesa. Koalicioni i gjerë i shoqërisë civile “Demokracia në Veprim”, i udhëhequr nga KDI, me 5,000 vëzhgues të angazhuar në ditën e zgjedhjeve kishte dështuar të dorëzonte një ankesë të vetme. Energjia e të gjithë akterëve ishte fokusuar kryesisht në akuza verbale mediale për keqpërdorime. Andaj, obligim i tyre është që të ndjekin rrugën ligjore dhe institucionale për të provuar cilëndo shkelje të pretenduar duke lejuar organet gjyqësore që të vendosin drejtësinë në këto raste.